REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRY FOR EUROPE
AND FOREIGN AFFAIRS

15.04.2021

- ***Njoftim lidhur me kufizimet e shteteve në raport me regjimin e lëvizjes së qytetarëve shqiptarë:***

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nisur nga situata e krijuar prej kufizimeve të lëvizjes së lirë të udhëtarëve jashtë vendit, me qëllim parandalimin e situatave problematike, informon në kohë reale për çdo ndryshim të këtij regjimi që lidhet me lëvizjen e qytetarëve shqiptarë.

- **Anglia (Mbretëria e Bashkuar)**

Në Mbretërinë e Bashkuar mund të hyjnë nga Shqipëria shtetasit e këtyre vendeve (Irlandë dhe MB) dhe të gjithë shtetasit e tjerë, (përfshirë ata shqiptarë) që kanë leje qëndrimi në këto vende. Rregullat e udhëtimit:

1. Të jeni 3 orë përpara udhëtimit në aeroport, për shkak të listës së gjatë të kontrollit të dokumentave që kërkohen nga shteti britanik dhe kompania ajrore.
2. Tamponi PCR i 72 orëve të fundit
3. Vërtetimi qe keni bërë pagesën për kryerjen e testit COVID, ditën 2 dhe 8 pasi të keni mbërritur në Angli. Pasi keni kryer këtë hap, ju jepet një kod dhe ky kod përfshihet në formularin PLF që duhet ta keni në check-in me detyrim, të plotësuar.
   Referohuni edhe këtij linku: https://www.gov.uk/…/providers-of-day-2-and-day-8-coronavir…
4. PLF (Formulari Passenger Locator Form) duhet të jetë i plotësuar me kujdes.
   https://provide-journey-contact-details.homeoffice.gov.uk/p…
5. Për të gjithë ata që vijnë nga Anglia, karantina në Shqipëri nuk është më detyrim, si edhe për ata që aktualisht ndodhen në Shqipëri.

Për më shumë klikoni në faqen zyrtare:https://www.gov.uk/uk-border-control

- **Arabia Saudite**

Informacion i Përgjithshëm:
Informacion i azhornuar në kohë reale në lidhje me rastet e të prekurve me korona-virus në Mbretëri, mund të aksesohen përmes faqes web të Ministrisë së Shëndetësisë https://covid19.moh.gov.sa/, në gjuhën arabe dhe angleze.

-Pezullimi i përkohshëm i hyrjes në mbretëri për pasagjerët që vijnë nga: (Argjentina, Emiratet Arabe, Gjermania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Indonezia, Irlanda, Italia, Pakistani, Brazili, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Afrika e Jugut, Suedia, Zvicra, Franca, Libani, Egjipti, India, Japonia) përfshirë edhe ato që vijnë nga vendet e tjera ose kanë kaluar brenda 14 ditëve në vendet e përmendura më lart.

- Qytetarët Sauditë, diplomatët, praktikuesit e shëndetit dhe familjet që vijnë nga vendet e lartpërmendura ose që kanë kaluar në ndonjë prej atyre vendeve brenda (14) ditëve para kthimit të tyre në Mbretëri do të karantinohen në shtëpitë e tyre për një periudhë prej (14) ditësh në Mbretëri.

-Procedurat shëndetësore parandaluese kundër përhapjes së Covid-19 zbatohen në lidhje me sigurimin e një testi negativ (PCR) para udhëtimit.

-Këto masa do të hyjnë në fuqi që nga ora 21:00, më 3 shkurt 2021.

Ministria Saudite e Shëndetësisë: https://www.moh.gov.sa/en/Pages/default.aspx/
MSH Llogari Twitter (Arabisht): https://twitter.com/saudimoh?lang=en/
Ministria Saudite e Punëve të Jashtme (Anglisht):
https://twitter.com/KSAmofaEN/
Informacion mbi mbajtjen e maskës (Arabisht): https://s.moh.gov.sa/Coronavirus/
Informacion mbi COVID19 (Arabisht): https://s.moh.gov.sa/Coronavirus/
Informacion mbi larjen e duarve (Arabisht): https://s.moh.gov.sa/Coronavirus/

Ministria e Shëndetësisë ka aktivizuar një qendër informacioni 24/24 për adresimin e shqetësimeve të ndryshme të qytetarëve rreth COVID-19 përmes kontaktit në numrin 937.

- **Armenia**

Armenia nuk lejon hyrjen nga shtetet e tjera, përveç shtetasve armenë dhe atyre me leje qëndrimi në Armeni. Shtetasit që hyjnë i nënshtrohen karantinës 14 ditore.

- **Argjentinë**

Hyrja në Argjentinë është e ndaluar deri më 9 Prill 2021 përjashtuar shtetasit argjentinas, të huajt me qëndrim të ligjshëm të vlefshme në Argjentinë dhe të afërmve të shtetasve argjentinas *.
Çdo person që hyn në Argjentinë kërkohet të paraqesë një test PCR të kryer maksimalisht 72 orë para imbarkimit, të ketë sigurim mjekësor që mbulon shpenzimet e lidhura me COVID-19 (përveç shtetasve dhe rezidentëve argjentinas) dhe të plotësojë një deklaratë elektronike për hyrje në territorin kombëtar: https://ddjj.migraciones.gob.ar/app/home.php/

* Bashkëshortët, partnerët e regjistruar, vëllezërit ose fëmijët. Duhet të paraqitet prova e lidhjes me shtetasin argjentinas, një kopje të kartës së tyre të identitetit; pasagjeri duhet të jetë shtetas i një vendi sipas listës në linkun në vijim. Më shumë informacion në https://www.argentina.gob.ar/noticias/nuevos-requisitos-sanitarios-para-el-ingreso-al-pais/

- **Austri**

Qeveria e Austrisë ka caktuar një sërë rregullash për lëvizjen e shtetasve të huaj drejt Austrisë me qëllim, parandalimin, frenimin dhe menaxhimin e përhapjes së virusit të Koronës COVID-19. Më poshtë po parashtrojmë rregullat që prekin shtetasit shqiptarë për udhëtim drejt Austrisë. Këto rregulla hyjnë në fuqi në datën 1 prill 2021 dhe qëndrojnë në fuqi, në këtë formë, deri në datën 31 maj 2021.

- Shtetasit shqiptarë nuk lejohen të udhëtojnë drejt Austrisë përgjatë vazhdimit të pandemisë.
- Tranziti në Austri lejohet për shtetasit shqiptarë në rastet kur ata plotësojnë kushtet e qëndrimit në destinacion final. Në rast të tranzitit me automjet përmes Austrisë dhe mospasjes së një testi negativ me vete (në gjuhën angleze ose gjermane), shtetasit mund të përdorin vetëm pikat e karburantit për furnizim dhe nevoja personale, pa qëndruar më gjatë ose devijuar nga intinerari.

Rastet që përjashtohen nga ndalimi i udhëtimit drejt Austrisë përfshijnë:

- Kur shtetasit shqiptarë janë të pajisur me leje qëndrimi në Austri, në një nga vendet e Bashkimit Europian ose në një nga vendet e Zonës Shengen. Në këtë rast ata mund të udhëtojnë nëse janë të pajisur me test negativ (48 orë për testet e shpejta dhe 72 orë për test PCR), ose duhet të kryejnë test në Austri brenda 24 orëve nga mbërritja. Në çdo rast ata duhet t'i nënshtrohen karantinimit për 10 ditë. Nga karantina mund të dalin vetëm nëse pas pesë ditësh kryejnë sërish testim dhe testi rezulton negativ. Testimi mund të kryhet pa pagesë në qendrat shtetërore të testimit.
- Kur dëshmojnë se duhet të kryejnë vizitë shëndetësore e cila është emergjente. Në këto raste karantina nuk është e detyrueshme.
- Kur dëshmojnë se udhëtojnë për arsye studimi, arsye familjare apo vizitojnë partnerin e tyre të jetës. Arsyet familjare përfshijnë vizitat për arsye: kujdesi shëndetësor, pagëzimi, ditëlindjesh, vdekjesh ose martesash. Arsyet duhet të provohen. Vlerësimet kryhen nga autoritetet austriake rast pas rasti. Për vizita tek partnerët e jetës përfshihen bashkëshorti/ja, i fejuari/a apo kur provohet marrëdhënia në çift përmes dokumenteve të tjera. Vlerësimet kryhen nga autoritetet austriake rast pas rasti. Për këto raste karantina nuk është e detyrueshme.
- Kur dëshmojnë se udhëtojnë për arsye pune. Vlerësimet kryhen nga autoritetet austriake rast pas rasti. Për këto raste karantina nuk është e detyrueshme.

Theksojmë se, përpara udhëtimit drejt Austrisë, është e detyrueshme plotësimi elektronikisht i "formularit për lejimin paraprak të udhëtimit". Adresa zyrtare për plotësimin e formularit në gjuhën angleze dhe gjermane: https://entry.ptc.gv.at/en.html

- **Australi**

Fluturimet ajrore janë kufizuar maksimalisht për shkak të shpërthimit të një vale të re nga Covid19. Gjithashtu, aeroportet kryesore janë thuajse të mbyllur dhe për ata pak udhëtarë që mbërrijnë në këto vende, është e detyruar karantina prej dy javësh në hotel dhe kryerja e ekzaminimeve laboratorike.

- **Azerbajxhan**

Rregullat për hyrjen në vend janë më strikte dhe të ndara në kategori. Drejt Azerbajxhanit mund të udhëtojnë:

1) Shtetasit Azerbajxhanas;

2) Ata që kanë leje qëndrimi në këtë vend;

3) Përfaqësuesit diplomatikë dhe familjarët e tyre;

4) Ata që kanë leje pune në vend;

Për ata që janë jashtë kësaj kategorie edhe dëshirojnë të udhëtojnë, me kusht të një ftese nga një shtetas (person) nga Azerbajxhani, duhet të aplikojnë për leje në Kryeministrinë azere.Karantinë të detyruar nuk ka, por kërkohet testi negativ i PCR i 48 orëve të fundit. Sugjerohet vetë izolim.

- **Bahrein**

Ambasada e Mbretërisë së Bahreinit në Ankara, lidhur me pandeminë COVID-19 përcjell informacion mbi masat e marra, përkatësisht në link:

English Link:

https://www.dropbox.com/s/snjefqrpgflrg8m/20201026%20MOFA%20Covid %2019%20V8-HD%201080p.mp4?dl=0/

Arabic Link:

https://www.dropbox.com/s/i2hegdivcvucc7w/MOFA%20Covid%2019%20Ara bic%20V10-HD%201080p.mp4?dl=0/

-Linja 24/24 përmes kontaktit në numrin 444 është vendosur nga autoritetet e Ministrisë së Shëndetësisë së Bahreinit në lidhje me adresimin e rasteve të personave të dyshuar si të prekur nga korona-virusi apo edhe sqarimin me informacione rreth COVID-19.
Duke filluar nga data 9 prill, vijon të jetë e detyruar mbajtja e maskave nëpër mjediset publike.
Qeveria e Bahreinit ka zbatuar masa të thelluara për gjurmimin e rasteve si dhe karantinimin me qëllim reduktimin e përhapjes së virusit.

Qeveria e Bahrainit ka deklaruar se çdo person që shkel rregullat e karantinimit do duhet të përballet me dënim me burgim deri në 3 muaj si dhe një gjobë prej 10 000 BHD.

Më shumë infromacion mund të gjendet në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë së Bahreinit https://www.moh.gov.bh/?lang=ar/
Autostrada në rrugë detare, Mbreti Fahad, që lidh Bahreinin me Arabinë Saudite vijon të jetë e mbyllur për udhëtimet jo-komerciale. Nuk lejohet përdorimi i autostradës as nga banorët vendas dhe as nga turistët, deri në një njoftim të dytë.

Kriteret për hyrjet dhe daljet nga territori:

Bahreini ka zbatuar një sërë masash në aeroport për të reduktuar përhapjen e COVID-19, duke përfshirë: Janë pezulluar të gjitha vizat në mbërritje. Cdokush që përpiqet të hyjë në Bahrein duhet të ketë një leje qendrimi. Të gjithë pasagjerët do të testohen për COVID-19 me shpenzimet e tyre. Këto teste mund të kushtojnë 30 BHD (80$).
Për qytetarët që kanë vizë të vlefshme dhe nga testimi në aeroport rezultojnë negativë nga COVID-19, është hequr detyrimi për kryerjen e karantinës.

-Poseduesit e pasaportave diplomatike janë të përjashtuar nga detyrimi për pagesën e kostos së testit PCR.
Për një informacion më të azhornuar nga Qeveria e Bahreinit mbi kufizimet e udhëtimeve mbi hyrjen në Mbretëri si dhe kriteteret e karantinimit mund të klikoni në linkun vijues: Government of Bahrain Travel Information

-Në lidhje me informacionet e azhornuara mbi kufizimet e udhëtimeve/fluturimeve vizitoni faqen në Instagram të Ministrisë së Transportit të Bahreinit (@mtt_bahrain)

Procedurat aeroportuale dhe portuale:
Të gjithë pasagjerët të cilët mbërrijnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Bahreinit apo në Portet e vendit nga vende me raste të konformuara me COVID-19, do t'u jepet për tu plotësuar një pyetësor mbi shëndetin si dhe do të ekzaminohen.

Burime lokale:

Llogaria në Instagram e Ministrisë së Shëndetësisë së Bahreinit(@mohbahrain)
Llogaria në Instagram e Ministrisë së Arsimit të Bahreinit (@meobahrain), informacion i azhornuar mbi procesin

e mbylljes së shkollave.

Për çdo shqetësim shëndetësor apo ndonjë pyetje lidhur me COVID-19, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 444.

- **Belgjikë**

Mbretëria e Belgjikës ka vendosur shtyrjen e masave shtrënguese deri në datën 25 prill 2021. Pas kësaj date Komiteti Konsultativ do të rimblidhet për të bërë vlerësimin e situatës dhe marrjen e masave të reja.

Masat shtrënguese implikojnë edhe udhëtimet nga dhe drejt Belgjikës.

Udhëtimet jo esenciale drejt dhe nga Belgjika janë të ndaluara, si për shtetasit me qëndrim te rregullt në Belgjikë, ashtu edhe për ata me qëndrim të rregullt në një shtet tjetër të BE apo shtetasit jo rezident por në posedim të një vize. Informacion i detajuar se cili udhëtim është cilësuar esencial dhe jo esencial, si dhe për modalitetet që duhen plotësuar në rastet e udhëtimit esencial mund të gjenden ne linkun zyrtar: **https://www.info-coronavirus.be/en/travels/**

Të gjithë udhëtaret drejt Belgjikës, të cilët kanë pasur një qëndrim më tepër se 48 orë në vendet jashtë BE kanë detyrimin e plotësimit të **Formularit** t**ë Lokalizimit të Udhëtarit**. Dokumenti duhet të plotësohet jo më herët se 48 orë nga mbërritja në Belgjike dhe gjendet në linkun; **https://travel.info-coronavirus.be/fr/public-health-passenger-locator-form**

Në rastet e udhëtimit drejt Belgjikës udhëtarët kanë detyrimin të paraqesin rezultatin negativ të testit PCR, të kryer jo më herët se 72 orë. Një testim i dytë do të kërkohet në ditën e 7 te qëndrimit në Belgjikë. Përjashtohen nga ky rregull shtetasit që udhëtojnë me mjete private për një qëndrim më pak se 48 orë në territorin e Belgjikës. Informacion të detajuar mbi testin gjeni ne linkun: **https://www.info-coronavirus.be/en/testing/**

Me mbërritjen në Belgjikë, udhëtareve ju kërkohet karantinim për 7 dite, nëse në testimin e dytë rezultojnë negativ, atëherë mund te dilet nga karantina. Më shumë informacion mbi karantinimin dhe izolimin në linkun**:** **https://www.info-coronavirus.be/en/quarantine-isolation/**

- **Bjellorusi**

Të huajt dhe personat pa shtetësi (përveç atyre që kanë një leje qëndrimi të përkohshme/të përhershme në Bjellorusi) lejohen të hyjnë në Bjellorusi vetëm përmes aeroporteve.
- Të gjithë të huajt dhe personat pa shtetësi që kanë mbushur moshën gjashtë vjeç (përveç atyre që kanë një leje qëndrimi të përkohshme/të përhershme në Bjellorusi) për të hyrë në Bjellorusi u duhet një test negativ PCR, i kryer jo më shumë se 3 ditë para se të kalojnë kufirin. Vetëizolimi 10-ditor kërkohet vetëm për personat që vijnë nga vendet e përfshira në Listën e Ministrisë së Shëndetësisë të Bjellorusisë, në të cilat regjistrohen raste të infeksionit COVID-19 *(Shqipëria është e përfshirë në këtë listë).*
- Sa i përket kalimit të kufirit përmes pikave kufitare tokësore, për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, përveç atyre që kanë leje për qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm në Bjellorusi, hyrja në Republikën e Bjellorusisë është pezulluar përkohësisht.

- **Bolivi**

Hyrja në Bolivi është e ndaluar për pasagjerët që kanë qenë në Mbretërinë e Bashkuar në 14 ditët e fundit (kjo nuk zbatohet për qytetarët dhe rezidentët bolivianë). Shumica e fluturimeve ndërkombëtare janë pezulluar deri më 31 maj 2021. Udhëtarëve nga shumë vende, ndër to dhe nga Shqipëria, u kërkohet të paraqesin një test PCR të bërë maksimumi 10 ditë para mbërritjes në Bolivi. Gjithashtu duhet të dorëzohet formulari si në linkun e mëposhtëm: https://www.dgac.gob.bo/wp-content/uploads/2020/09/Form_Salud_International_EN.pdf

Mund të hyjnë vetëm shtetasit bolivianë dhe të huajt me qëndrim aktual të ligjshëm në Bolivi, të detyruar t'i nënshtrohen karantinës pasi të mbërrijnë në vend.

- **Bosnje-Hercegovinë**

-Rregulla të reja për hyrjen në Bosnje-Hercegovinë! Këshilli i Ministrave i Bosnje Hercegovinës, ka miratuar disa ndryshime mbi "Vendimin për përcaktimin e kushteve shtesë për hyrjen e të huajve në Bosnje Hercegovinë." Në përputhje me këtë vendim, ndalimi i hyrjes së të huajve në territorin e Bosnje Hercegovinës nuk do të zbatohet për shtetasit e vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të Shengenit, për të gjithë të huajt që kanë një vizë të shumëfishtë Shengen ose vizë të Bashkimit Evropian apo një leje qëndrimi përkatëse në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen, si dhe për të huajt që kanë një çertifikatë të testit negativ për virusin SARS-CoV-2, jo më të vjetër se 48 orë, para se të hyjnë në BiH. Ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 16 korrik 2020 dhe është ende në fuqi. BiH e ka vendosur Shqipërinë në "Zonën e Kuqe".

Shtetasit e Shqipërisë hynë në BiH vetëm nëse kanë një shkak të rëndësishëm, të cilin duhet ta vërtetojnë me anë të një dokumentacioni (ftesë/leje nga pala boshnjake), si dhe duhet të kenë, detyrimisht, certifikatën e testit negativ për virusin SARS-CoV-2, jo më të vjetër se 48 orë, para se të hyjnë në BiH. Për rastin konkret, për të hyrë në BiH, Ekipi duhet të ketë Ftesën nga pala boshnjake që tregon arsyen se pse do të futet në BiH (ndeshje), si dhe të gjithë personat duhet të kenë me vete certifikatën e testit negativ për virusin SARS-CoV-2, jo më të vjetër se 48 orë.

- **Brazil**

Lejohet hyrja në Brazil në rrugë ajrore e shtetasve të huaj. Kjo nuk vlen për pasagjerët e huaj të cilët në 14 ditët e fundit para mbërritjes në Brazil kanë qenë ose tranzituar përmes Afrikës së Jugut ose Mbretërisë së Bashkuar. Kushdo që dëshiron të hyjë në Brazil kërkohet të paraqesë një test PCR të bërë maksimalisht 72 orë para imbarkimit.
Është e nevojshme të paraqitet një formular shëndetësor: https://formulario.anvisa.gov.br/

- **Bullgari**

Autoritetet shëndetësore bullgare kanë vendosur ndalimin e përkohshëm të hyrjes në Bullgari për periudhën 1 prill - 30 prill 2021 të të gjithë shtetasve, pavarësisht nga shtetësia e tyre në të gjitha pikat e kalimit kufitar të transportit tokësor, ajror, detar dhe hekurudhor.

Hyrja në Bullgari e qytetarëve është e mundur me paraqitjen e përgjigjes negative të testit PCR të 72 orëve të fundit. Qytetarët bullgarë, familjarët e tyre dhe ata, që kanë leje qëndrimi bullgare mund të hyjnë edhe pa përgjigjen negative të testit PCR, por do t'i nënshtrohen karantinës së detyrueshme 10 ditore.

Qytetarët shqiptarë mund të hyjnë në Bullgari duke paraqitur përgjigjen negative të një testi PCR të kryer 72 orët e fundit. Qytetarët shqiptarë të pajisur me leje qëndrimi bullgare mund të hyjnë në Bullgari edhe pa përgjigjen negative të testit PCR, por do t'i nënshtrohen karantinës së detyrueshme 10 ditore.

Mund të hyjnë në territorin e Bullgarisë duke paraqitur përgjigjen negative të testit PCR:

1. shtetasit bullgarë, shtetasit e shteteve të BE-së, Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut, vendeve të zonës Shengen duke përfshirë Republikën e San Marinos, Principatën e Andorrës, Principatën e Monakos dhe shtetin e Vatikanit, anëtarët e familjeve të tyre, ku përfshihen edhe personat, që janë në një bashkëjetesë reale si dhe qytetarët e Australisë, Kanadasë, Gjeorgjisë, Japonisë, Zelandës së Re, Republikës së Ruandës, Republikës së Koresë, Mbretërisë së Tajlandës, Republikës së Tunizisë, Republika së Uruguait, Emirateve të Bashkuara Arabe, Ukrainës, Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Serbisë, Republikës së Shqipërisë, Kosovës, Bosnjë dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Republikës së Moldavisë, Izraelit, Kuvajtit, Republikës së Bjellorusisë dhe Republikës së Turqisë; personat me leje qëndrimi të përhershëm ose afatgjatë në territorin e Bullgarisë dhe anëtarët e familjes; personat e pajisur me vizë "D" si dhe personat me leje qëndrimi të një vendi anëtar të BE-së, Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës së Veriut ose një vendi të zonës Shengen duke përfshirë Republikën e San Marinos, Principatën e Andorrës, Principatën e Monakos dhe shtetin e Vatikanit dhe anëtarët e familjes së tyre;
2. profesionistët dhe studiuesit mjekësorë si dhe punonjësit socialë, kur qëllimi i udhëtimit lidhet me përmbushjen e detyrës;
3. punonjësit e përfshirë në transportin e produkteve dhe pajisjeve mjekësore, pajisjeve personale mbrojtëse duke përfshirë edhe instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;
4. personeli i transportit i angazhuar në sektorin e transportit, transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, ekuipazhi i avionëve të transportit të mallrave, ngarkesave dhe pasagjerëve si dhe ekuipazhi i anijeve dhe personat e angazhuar me mirëmbajtjen e anijeve;
5. zyrtarët e huaj (Krerët e shteteve, Ministrat, anëtarët e Qeverive etj.), anëtarët e delegacioneve të tyre, diplomatët, personeli tekniko-administrativ, personeli ushtarak, oficerët e sigurisë dhe rendit publik, punonjësit humanitar në kryerjen e detyrave të tyre si dhe familjarët e zyrtarëve të mësipërm;
6. personat, që udhëtojnë për qëllime humanitare në përputhje me nenin 1, pika 16 e ligjit "Për të huajt" në Bullgari;
7. përfaqësuesit tregtar dhe investitorët ekonomikë si dhe personat, që lidhen drejtpërdrejtë me ndërtimin, mirëmbajtjen, operimin dhe sigurimin e sigurisë së infrastrukturës strategjike të Bullgarisë, zbatimin e projekteve të certifikuara sipas Aktit të Nxitjes së Investimeve, analizave nga projektet e investitorëve të mundshëm dhe aktiviteteve të tjera të rëndësishme për ekonominë e vendit, vërtetuar nga një letër e Ministrisë së Ekonomisë ose një tjetër Ministrie përgjegjëse për veprimtarinë përkatëse si dhe personat e përfshirë në ndërtimin e anijeve dhe riparimin e tyre si dhe anëtarët e familjeve të tyre. Letra e Ministrisë përkatës u paraqitet autoriteteve të kontrollit kufitar;
8. punëtorët sezonalë të bujqësisë dhe turizmit;
9. punonjësit e pikave kufitare;
10. personat, që udhëtojnë për pjesëmarrje në provime, kur nuk ofrohet mundësia e provimit në distancë ose elektronikisht;
11. organizatorët dhe pjesëmarrësit në garat ndërkombëtare sportive për kohën e zhvillimit të aktivitetit, atletë nga jashtë, që vijnë për testim, për pjesëmarrje në trajnime stërvitore, familjarët e sportistëve dhe trajnerëve të huaj, mbajtësit e vizës "D". Këta subjekte duhet të kenë një letër nga Ministria e Rinisë dhe Sporteve, ku përcaktohen emrat e personave dhe adresa e vendqëndrimit në Bullgari. Letra u dorëzohet autoriteteve të kontrolli kufitar;
12. personat, që janë në procedurë për marrjen e dekretit të shtetësisë bullgare, kur janë të pajisur me letrën e Ministrisë së Drejtësisë;
13. organizatorët dhe pjesëmarrësit e aktiviteteve kulturore për kohën e zhvillimit të aktivitetit, të pajisur me një letër nga Ministria e Kulturës, ku përcaktohen emri i personave dhe adresa e vendqëndrimit në Bullgari. Letra u dorëzohet autoriteteve të kontrollit kufitar.

Subjektet e mësipërme mund të kalojnë edhe transit në territorin e Bullgarisë. Transiti lejohet vetëm në rastet kur garantohet largimi i menjëhershëm nga territori i Bullgarisë.

Nuk i nënshtrohen detyrimit të paraqitjes së përgjigjes negative të testit PCR vetëm subjektet e mëposhtëm:

1. drejtuesit e autobusëve të transportit ndërkombëtar të pasagjerëve;

2. drejtuesit e kamionëve, që janë duke kryer ose përfunduar kursin e tyre për transportin ndërkombëtar të mallrave dhe atyre që hyjnë në territorin e Bullgarisë;
3. anëtarët e ekuipazhit të avionëve dhe anijeve;
4. punonjësit e kufirit pavarësisht shtetësisë së tyre;
5. qytetarët, që kalojnë transit në territorin bullgar;
6. nxënësit dhe studentët, që jetojnë në Republikën e Greqisë, Turqisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Rumanisë dhe udhëtojnë çdo ditë ose të paktën një herë në javë në Republikën e Bullgarisë për qëllime trajnimi si dhe studentët, që jetojnë në Republikën e Bullgarisë dhe udhëtojnë çdo ditë ose të paktën një herë në javë në Republikën e Greqisë, Turqisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Rumanisë për qëllime trajnimi;
7. personat, që kalojnë transit përmes territorit të Bullgarisë.

Në përputhje me urdhrat e nxjerrë nga autoritetet shëndetësore, hyrja në Bullgari mund të bëhet përmes pikave të mëposhtme të kalimit të kufirit shtetëror:

Nga Rumania:

1. Vidin – Calafat;
2. Durankulak;
3. Russe – Giurgiu.

Nga Serbia:

1. Vrashka Chukka;
2. Kalotina;
3. Strezimirovci.

Nga Maqedonia e Veriut:

1. Gyueshevo;
2. Stanke Lisichkovo;
3. Zlatarevo;
4. Ilinden

Nga Turqia:

1. Kapitan Andreevo;
2. Malko Tarnovo

Nga Greqia:

1. Kapitan Petko Voyvo;
2. Kulata
3. Makaza.

- Hyrja në Bullgari mund të bëhet gjithashtu në pikat kufitare në aeroportet e mëposhtme:

1. Aeroporti i Burgasit;
2. Aeroporti i Varnës;
3. Aeroporti i Plovdivit;
4. Aeroporti i Sofjes (Terminali 1 dhe Terminali 2).

- **Çekia**

Vazhdojnë të jenë në fuqi kufizimet për të lejuar vetëm udhëtimet për arsye thelbësore, që përfshijnë: udhëtimin për punë, vizita në institucionet e kujdesit shëndetësor ose në funerale.

Gjithashtu, në Republikën Çeke mund të hyjnë vetëm personat që kanë rezidencë në një vend të BE-së ose janë të pajisur me vizë pune dhe studimi. Udhëtimi vetëm me pasaportë nuk lejohet.

Shqipëria është e renditur në listën e vendeve me rrezikshmëri të lartë infektimi dhe është e shënuar me të kuqe të erret në hartën e përgatitur nga institucionet kompetente çeke. Harta e përditësuar e vendeve me ngjyrat përkatëse gjendet: https:/www.mzv.cz/jnp/cz/mapa_cestovatele.html

Pasagjerët që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që udhëtojnë nga vendet që janë të shënuara me ngjyrën e kuqe të errët (si shtetasit çekë ashtu edhe të huajt), duhet të zbatojnë rregullat e mëposhtme:

-të plotësojnë on line formularin e mbërritjes (para udhëtimit). www.prijezdovyformular.cz

-të kenë me vete një rezultat negativ të testit PCR, para se të udhëtojnë në Çeki (rezultati nuk duhet të jetë më i vjetër se 48 orë).

- pas arritjes në Çeki duhet t'i nënshtrohen një karantine pesë-ditore.

- pas përfundimit të karantinës duhet të ribëjnë edhe një tjetër test PCR dhe të raportojnë rezultatin menjëherë në Zyrën përkatëse të Higjienës.

- Në rast të një rezultati negativ të testit të dytë PCR, personat do të kenë detyrimin e mbajtjes së një maske respiratore të nivelit: FFP2, KN95, N95, P2, DS, për së paku 14 ditë që nga mbërritja, sa herë dalin nga shtëpia.

- **Danimarkë**

Personi duhet të ketë një test negativ Covid, për të cilin kampioni është marrë brenda 24 orësh nga momenti që ka bërë boarding në fluturim ose nga momenti që hyn në kufirin danez (me rrugë tokësore). Nëse fluturimi është me transit, kjo vlen për fluturimin e parë që niset nga Tirana.

Personi do të testohet sërish sapo të mbërrijë në Danimarkë, ditën e parë, si dhe ditën e katërt me një test PCR. Ndërkohë, personi do të karantinohet në Danimarkë për 10 ditë. Nëse testi i ditës së katërt rezulton negative, personi mund të dali nga karantina e detyrueshme. Nëse personi nuk e ndjek këtë rregull, mund të gjobitet nga autoritetet daneze me një gjobë të vlerës 3500DKK.

Shtetasit ose rezidentët danezë mund të hyjnë në Danimarke në çdo kohë, pavarësisht arsyes.

Të huajt që nuk janë rezidentë në Danimarkë duhet të kenë një arsye të fortë për të hyrë në Danimarkë.

Arsyet e konsideruara të forta janë si më poshtë:

Çështje pune:
- personi është i punësuar në Danimarkë
- personi do të marrë pjesë në një takim të rëndësishëm biznesi
- personi do të kryejë shërbime ose transportojë mallra brenda ose jashtë Danimarkës
- personi është marinar, pjesë e ekuipazhit të një mjeti ajror ose diplomat

Çështje personale:

- Personi është bashkëshorti/ja, partneri/ja bashkëjetues, i/e fejuar, i/e dashur, prindi, njerku/a, gjyshi/ja, prindërit e njerkut/ës, fëmija, thjeshtri/a, motra, vëllai, motra/vëllai prej njerkut/njerkës, nipi/mbesa e gjyshërve, nipi/mbesa i gjyshërve të njerkut/njerkës. Sa më sipër, kur lidhja është me një shtetas danez ose rezident në Danimarkë. Kjo lidhje vërtetohet me një dokument/certifikatë. Sa i takon lidhjeve, duhet që lidhja dashurore të ketë zgjatur minimalisht 3 muaj dhe të ketë patur kontakt në person, dhe jo bazuar mbi kontakte virtuale (mesazhe telefonike dhe video). Për këto raste ka një formular specifik që personi duhet të plotësojë, i gjendur në website-n: https://en.coronasmitte.dk/rules-and-regulations/entry-into-denmark/persons-resident-in-countries-outside-of-denmark
- Personi është bashkëshorti/ja, partneri/ja bashkëjetues, fëmija ose thjeshtri i një diplomati, dhe kjo vërtetohet me pasjen e një pasaporte diplomatike.
- Personi ka radhën e kujdestarisë ndaj një fëmije minoren, duke e vërtetuar me një certifikatë lindje.
- Personi është kujdestari primar i një fëmije minoren, për shembull fëmijë të adoptuar, duke e vërtetuar me dokumente lëshuar nga autoritetet.
- Personi ka lidhje familjare me një të sëmurë rëndë ose një person në prag vdekje në Danimarkë. Lidhje familjare konsiderohen: bashkëshorti/ja, partneri/ja bashkëjetues, i/e fejuar, i/e dashur, prindi, njerku/a, gjyshi/ja, prindërit e njerkut/ës, fëmija, thjeshtri/a, motra, vëllai, motra/vëllai prej njerkut/njerkës, nipi/mbesa e gjyshërve, nipi/mbesa i gjyshërve të njerkut/njerkës, vjehrrit, nusja/dhëndëri. Kjo arsye vërtetohet me një dokument mjekor të lëshuar nga një institucion shëndetësor, me aprovimin e të sëmurit.
- Personi do të marrë pjesë në lindjen e fëmijës së tij, me aprovimin e mamasë së fëmijës. Kjo provohet me një dokument regjistrimi amësie dhe me një letër aprovimi nga mamaja e fëmijës që personi është prindi i fëmijës dhe ajo e dëshiron pjesëmarrjen e tij në lindje.
- Personi do të vazhdojë trajtimin shëndetësor në një institucion danez të shëndetit, shtetëror ose privat. Kjo vërtetohet me një njoftim nga institucioni shëndetësor.
- Personi do të marrë pjesë në një funeral të një familjari të ngushtë ku përfshihen: bashkëshorti/ja, partneri/ja bashkëjetues, i/e fejuar, i/e dashur, prindi, njerku/a, gjyshi/ja, prindërit e njerkut/ës, fëmija, thjeshtri/a, motra, vëllai, motra/vëllai prej njerkut/njerkës, nipi/mbesa e gjyshërve, nipi/mbesa i gjyshërve të njerkut/njerkës, vjehrrit, nusja/dhëndëri.

Çështje ligjore
- Personi do të marrë pjesë në një procedurë ligjore ose është thirrur në një intervistë nga autoritetet publike. Kjo vërtetohet me një letër-thirrje nga gjykata ose dokument nga autoriteti me të cilin personi ka takimin.

Faqja zyrtare në të cilën gjendet informacion i përditësuar lidhur me hyrjen në Danimarkë është si më poshtë: https://en.coronasmitte.dk/rules-and-regulations/entry-into-denmark

- **Ekuador**

Lejohet hyrja në Ekuador në rrugë ajrore e shtetasve të huaj. Është e nevojshme të paraqitet një test negativ molekular-PCR i kryer brenda një periudhe maksimale prej 3 ditësh para udhëtimit ose një certifikate vaksinimi. Nevojitet të paraqitet formulari i Deklaratës së Shëndetit të Udhëtarit si në vijim:
https://www.cancilleria.gob.ec/wp-content/uploads/2020/06/formulario_de_salud_del_viajero_revisado.pdf.pdf_1-1.pdf/

- **Emiratet e Bashkuara Arabe**

Në bazë të marrëveshjes dypalëshe mes ALB-EBA, mbi regjimin e vizave, përfitojnë këto kategori:

- Shtetasit e Emirateve të Bashkuara Arabe, mund të udhëtojnë pa vizë drejt Shqipërisë (të gjitha llojet e pasaportave), dhe mund të qëndrojnë në territor deri në 90 ditë nga momenti i hyrjes. Në rast se shtetasit Emiratas kërkojnë të qëndrojnë më gjatë për qëllime punësimi apo biznesi, duhet të aplikojnë për vizë tipi D dhe të ndjekin procedurat për pajisje me Leje Qëndrimi.

- Shtetasit shqiptarë mbajtës të pasaportave Diplomatike dhe Shërbimi, udhëtojnë pa vizë drejt Emirateve të Bashkuara.

- Ndërkohë, shtetasit shqiptare mbajtës të pasaportave të thjeshta, duhet të aplikojnë për vizë për të hyrë në territorin Emiratas. EBA kanë sistemin e vizave Elektronike (e-visa), ku shtetasit tanë mund të aplikojnë nëpërmjet agjencive ku presin biletat e udhëtimit, ose mund te aplikojnë online nëpërmjet Website-ve që gjenden në internet.(UAE e-visa).

- **Estoni**

Udhëtimi për në Estoni është i mundur për personat e mëposhtëm:

- Qytetarët estonezë, banorët dhe anëtarët e familjes së tyre. Qytetarëve dhe banorëve të Estonisë u lejohet hyrja, pavarësisht nëse ato tregojnë apo jo simptoma të sëmundjes.

- Qytetarët dhe banorët e Bashkimit Evropian, zonës Shengen, Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Andorra, Monako, San Marino dhe Vatikan, dhe individë asimptomatikë me një vizë qëndrimi afatëgjatë dhe anëtarët e familjes së tyre. Lexoni listën këtu.

- Qytetarët e vendeve të renditura në Shtojcën 1 të rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian. (Australia, New Zealand, South Korea, Rwanda, Thailand, Singapore)

-Qytetarë asimptomatikë të shteteve të huaja që mbërrijnë në Estoni nga shtetet që nuk përmenden më lart për punë ose studime dhe anëtarët e familjes së një specialisti të nivelit të lartë që vijnë për të punuar në Estoni me një vizë dhe anëtarët e familjes së një shtetasi të huaj që vijnë për të punuar në një kompani fillestare ose në fushën e ICT në Estoni.

- Përjashtimet zbatohen për njerëzit që transportojnë mallra dhe lëndë të parë, njerëzit e përfshirë në transportin ndërkombëtar të mallrave ose udhëtarëve, njerëzit që kryejnë detyra teknike për kompanitë me bazë në Estoni, ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, diplomatët, njerëzit që mbërrijnë për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar dhe njerëzit me një leje hyrje të veçantë. Të gjitha përjashtimet renditen në Urdhrin Nr. 282 të Qeverisë së Estonisë.

Sipas listës së vendeve të treta të përfshira në Aneksin 1 të rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian për heqjen graduale të kufizimeve të përkohshme për udhëtimet jo-thelbësore në BE *, është e mundur të udhëtosh në Estoni nga Australia, New Zelanda, Ruanda, Singapori, Koreja e Jugut dhe Tajlanda. Një periudhë 10-ditore e kufizimeve në lëvizje është e detyrueshme për pasagjerët që vijnë nga vendet me një normë infeksioni mbi 16 njerëz për 100 000 banorë në 14 ditët e fundit. Midis 29 Mars dhe 4 Prill 2021 detyrimi i kufizimeve të lëvizjes nuk do të zbatohet me mbërritjen nga ndonjë prej vendeve të renditura në Shtojcën 1.

Shtetasit e vendeve të treta që arrijnë për punë ose për studime në një institucion arsimor të regjistruar në Estoni nga një vend i tretë që nuk përfshihen në Aneksin 1 të rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtarët e familjes së një specialisti të nivelit të lartë që vijnë për të punuar në Estoni me një vizë dhe anëtarët e familjes së një shtetasi të huaj që vijnë për të punuar në një kompani fillestare ose në fushën e TIK në Estoni i

nënshtrohen periudhës 10-ditore të detyrueshme të kufizimeve të lëvizjes. Ata duhet të bëjnë një test të koronavirusit menjëherë pas mbërritjes në Estoni dhe një provë të dytë jo më herët se gjashtë ditë pas testit të parë. Testimi nuk jep të drejtën për të ndaluar vetë-izolimin para se të mbarojë periudha e detyrueshme.

Karantina:

Rregullat e mëposhtme zbatohen për uljen e periudhës së kufizimeve të lëvizjes (si kur mbërrin nga Evropa dhe rajone të tjera, përveç shtetasve të vendeve të treta që mbërrijnë në Estoni për punë ose studime).

(1) Kushdo që nuk dëshiron të vet-izolohet për 10 ditë pas mbërritjes së tij në Estoni mund të marrë një test PCR jashtë vendit jo më herët se 72 orë para mbërritjes së tij në Estoni. Ndërsa në Estoni, një provë e dytë mund të bëhet jo më herët se në ditën e gjashtë pas testit të parë. Kufizimet 10-ditore në periudhën e lëvizjes mund të përfundohen më herët nëse të dy testet janë negative.

(2) Kushdo që nuk ka marrë një test deri në 72 orë para mbërritjes së tyre në Estoni, mund të bëjë një menjëherë pas mbërritjes dhe testin e dytë jo më herët se gjashtë ditë pas testit të tyre të parë. Kufizimet 10-ditore në periudhën e lëvizjes mund të përfundohen më herët nëse të dy testet janë negative.

Informacioni në lidhje me kushtet që vlejnë për certifikatën e testit është në dispozicion link: https://vm.ee/en/coronavirus-2019-ncov. Për rezervimin e një testi të dytë, udhëtarët mund të kontaktojnë qendrën e thirrjeve për testimin publik (678 0000).

Detajet rreth testimit janë në dispozicion në faqen e internetit:

https://koroonatestimine.ee/en/for-patients/testing-after-a-trip-abroad/.

Kufizimet 10-ditore në lëvizje dhe testimin e COVID-19 nuk janë të detyrueshme për individët (si kur vijnë nga Evropa dhe rajone të tjera), të cilët:

(1) kanë kaluar COVID-19 dhe nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj që kur janë deklaruar të kuruar;

(2) i janë nënshtruar vaksinimit COVID-19 dhe nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj nga përfundimi i tij.

Informacioni në lidhje me certifikatat e kërkuara është në dispozicion në link: https://vm.ee/en/coronavirus-2019-ncov

Informacioni për vendet dhe kufizimet në lëvizje rishikohet çdo javë dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme: https://vm.ee/en.

- **Egjipti**

Egjipti, nga data 16 gusht, të gjithë udhëtarët, të çfarëdo shtetësie qofshin, duhet të paraqesin testin negativ të COVID-19, të bërë deri 72 orë përpara mbërritjes. Qeveria Egjiptiane mori këtë vendim, me qëllim rritjen e masave dhe kujdesit, për shkak të numrit të turistëve, që pavarësisht pandemisë mbetet i lartë. Nga ky rregull përjashtohen të gjithë të huajt, që kanë leje qëndrimi në Egjipt.

- **Finlandë**

Kufizimet për hyrjen në Finlandë do të vazhdojnë deri më 30 Prill 2021.
Hyrja në Finlandë lejohet vetëm për arsye të domosdoshme dhe të justifikuara, të tilla si studime ose arsye të lidhura me familjen, etj. (shih më poshtë).

Të gjithë që mbërrijnë në Finlandë nga vendet me rrezik të lartë kërkohet të marrin pjesë në një ekzaminim shëndetësor për të përcaktuar nëse janë të infektuar me COVID-19. Vendet me rrezik të lartë janë vendet me një prekje të lartë të koronavirusit ose vende pa informacion të mjaftueshëm për numrin e infeksioneve COVID-19.

Ju nuk keni nevojë të bëni një test të Covid 19 në pikën e kalimit kufitar nëse keni:
· një vërtetim të një testi negativ të koronavirusit deri në 72 orë; ose
· një vërtetim që keni kaluar Covid 19 në më pak se 6 muaj më parë.
Përveç kësaj, autoritetet shëndetësore do t'ju kërkojnë informacionin tuaj të kontaktit në mënyrë që mjeku i sëmundjes infektive në komunën tuaj të banimit të mund t'ju referojë për të bërë një test brenda 72 orësh, si dhe informacioni juaj të mund të përdoret për të gjurmuar infeksionin. Dhënia e informacionit të kontaktit është e detyrueshme.

Nëse e refuzoni testin, një Mjek i Kontrollit të Sëmundjeve të Ngjitëse mund t'ju urdhërojë të vendoseni në karantinë zyrtare 14 ditore. Vendimi për ndërprerjen e karantinës zyrtare merret nga Mjeku.
Lejohen të udhëtojnë në Finlandë nga shtetet e vendeve të treta:

Kthim në Finlandë:
· Shtetasit finlandezë dhe anëtarët e familjes të tyre;
· Shtetasit e BE dhe vendeve Schengen, rezidentë në Finlandë dhe anëtarët e familjes së tyre;
· Shtetasit e vendeve te treta rezidentë ne Finlandë me leje qëndrimi;
· Shtetasit e BM dhe anëtarët e familjes të tyre rezidentë në Finlandë, tek të cilët aplikohet Marrëveshja Tërheqjes;

Kthimi nga ose përmes shteteve të tjera të BE ose Schengen-it:
· Shtetasit e vendeve të tjera të BE-së dhe Shengenit dhe anëtarët e familjes së tyre
· Shtetasit e vendeve të treta që banojnë në një vend tjetër të BE-së ose Shengenit me leje qëndrimi;
· Shtetasit e BM dhe anëtarët e familjes të tyre rezidentë në Finlandë, tek të cilët aplikohet Marrëveshja Tërheqjes;

Udhëtimi për arsye esenciale:
· Puna që është e rëndësishme për funksionimin e shoqërisë ose sigurimin e furnizimit, zbatimi i së cilës kërkon kryerjen e punës nga një person ose persona që vijnë nga një vend tjetër dhe puna nuk mund të vonohet;
· Personeli i shërbimit të kujdesit shëndetësor (përfshirë ndihmën e parë) dhe profesionistët e kujdesit për të moshuarit, si dhe personeli autoritar që kryen detyra thelbësore të punës;
· Diplomatët; stafi i organizatave ndërkombëtare, personeli ushtarak dhe punonjësit e ndihmës humanitare gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;
· Përfaqësuesit e shtetit që marrin pjesë në negociatat ndërkombëtare dhe personat e angazhuar në punë për OJQ-të ndërkombëtare
· Personat që udhëtojnë me leje qëndrimi finlandeze;
· Personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare ose që udhëtojnë për arsye të tjera humanitare;
· Çështje familjarë të ngutshme (për shembull, lindja e fëmijës tuaj, një sëmundje serioze e një të afërmi të afërt, martesa) ose arsye të tjera personale ngutshme;

· Udhëtime të nevojshëm dhe të justifikuara, siç janë përfaqësuesit e mediave të huaja; transiti i shërbimeve ajrore të planifikuara në aeroporte dhe ardhja e një anëtari të familjes së një shtetasi finlandez që jeton jashtë vendit.

Grupet speciale(si, përfaqësues të kulturës, sportit dhe jetës së biznesit).
Vini re: Garda Kufitare Finlandeze nuk jep leje paraprake për hyrje në Finlandë. Në trafikun e kufirit të jashtëm dhe ku është rivendosur kontrolli i kufirit të brendshëm, vendimi për të lejuar hyrjen merret gjithmonë gjatë kontrolleve të kufirit.
Detyrimi juaj është të keni një informacion të plotë, prandaj për lutemi të përditësoheni vazhdimisht mbi masat e marra në këto link-e:

· https://raja.fi/en/guidelines-for-border-traffic-during-pande

· https://thl.fi/en/web/infectious-diseases-and-vaccinations/what-s-new/coronavirus-covid-19-latest-updates/travel-and-the-coronavirus-pandemic

- **Franca**

-Bazuar në dekretin nr.2020-860, datë 10 korrik 2020, të ndryshuar më datë 31 korrik 2020, neni 11, paragrafi II, shtojca 2bis dhe 2ter, të qeverisë së Republikës Franceze, qytetarët shqiptarë dhe ata të huaj që udhëtojnë me linja direkte nga Shqipëria drejt Francës, nuk janë të detyruar të paraqesin rezultatet e testit biologjik për praninë e COVID-19 dhe as të bëjnë këtë test në momentin e hyrjes në territorin francez.Gjithashtu, udhëtarët me linja direkte nga Shqipëria drejt Francës, nuk kanë detyrim të izolohen (karantinë), në rast se nuk shfaqin asnjë shenjë që mund të gjykohet si e dyshimtë nga autoritetet e kufirit në Francë. Për udhëtarët që fluturojnë nëpërmjet Serbisë apo Turqisë, autoritetet franceze mund të kërkojnë paraqitjen e rezultatit të testit biologjik për praninë e COVID-19, jo më të vjetër se 72 orë, ose kryerjen e testit me detyrim në momentin e hyrjes në Francë. Kujtojmë se aktualisht mund të hyjnë në Francë vetëm ata shtetas shqiptarë të cilët zotërojnë një vizë afatgjatë të tipit D ose një lejeqëndrimi të vlefshme franceze apo të një vendi tjetër të BE-së.

-Përjashtim bëjnë vetëm diplomatët, vizitat zyrtare si dhe punonjësit e transportit apo stafet mjeksore dhe humanitare. Për kategoritë që lejohet, aktualisht nuk ka detyrim testi të COVID-19 apo karantinim të detyrueshëm për shtetasit shqiptarë.

- **Greqi**

-Sipas autoriteteve greke, do të lejohen të dalin nga Greqia dhe të hyjnë në Shqipëri nëpërmjet pikës kufitare të Kapshticës, këmbësorët, automjetet private dhe mjetet e tonazhit të rëndë, nga ora 06:00 deri në orën 22:00. Hyrja në Greqi nga kjo pikë kalimi do të vijojë të jetë e mbyllur.

-Lejohet kalimi i njerëzve, automjeteve, kamionëve në pikën kufitare të Kakavijës dhe të Evzoni. Në rast kalimi, aplikohet vetëkarantinim i detyrueshëm 14 ditësh. Të gjithë udhëtarët që hyjnë nga pikat kufitare ajrore, kanë detyrim të vetëkarantinohet 7 ditë. Pavarësisht shtetësisë dhe në rast shkelje, do të aplikohet gjobë prej 5000€.

-Për shkak të situatës epidemiologjike, të gjithë pikat e kufitare Greke janë të hapura vetëm për "udhëtarët thelbësorë" përveç pikës kufitare të Promachonas në Bullgari. "Udhëtarët thelbësorë" në kufijtë tokësorë konsiderohen: shtetasit grekë, banorët me vendbanim të përhershëm në Greqi, punonjës të transportit dhe udhëtarët për arsye thelbësore profesionale. Këto kategori udhëtarësh mund të hyjnë në Greqi nga pikat kufitare të Kakavijës, Evzoni, Kipi (levizje lejohet nga ora 07.00 deri në orën 19.00).

-Që nga data 01/03/2021, orari i lëvizjes në pikën kufitare të Kakavijës është nga ora 7:00- 19:00. Është e lejuar të kalojnë vetëm 400 persona në ditë.

-Për më shumë, qytetarët që hyjnë në Greqi, përveç paraqitjes së testit negativ PCR (testi molekular) të kryer deri në 72 orë më parë, do të kryejnë edhe rapid test, gjatë hyrjes në territorin grek, nga Njësi të Sekretariatit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Civile dhe Organizatës Kombëtare të Shëndetit Publik të Greqisë. Në rast se personi rezulton pozitiv në rapid testin që kryhet në pikën kufitare të Kakavijës, nuk do ti lejohet hyrja në territorin grek. Fëmijët nën 10 vjeç nuk i nënshtrohen detyrimit për një test PCR..

-Vetëm udhëtarët që mbajnë një certifikatë me rezultat negativ të testit RT-PCR do të lejohen nga autoritetet kufitare të hyjnë në vend. Certifikatat duhet të jenë në gjuhën angleze dhe të mbajnë emrin dhe numrin e pasaportës/numrin e identitetit kombëtar të udhëtarit.

Laboratorët që kryejnë testimin RT-PCR duhet të jenë:

-Laboratorët e Referencës Kombëtare

-Laboratorët Kombëtarë të Shëndetit Publik ose

-Laboratorë privatë të cilët janë të akredituar nga autoritetet përkatëse kombëtare të akreditimit (jo domosdoshmërisht specifikisht për COVID-19).

-Certifikatat që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme nuk do të pranohen.

-Falsifikimi i certifikatës ndëshkohet nga Ligji Grek.

Të gjithë udhëtarët duhet të respektojnë të gjitha masat e nevojshme parandaluese të përhapjes së Covid-19, si përdorimi i maskave dhe distancimit fizik, sipas udhëzimeve lokale.

Të gjithë udhëtarët duhet të plotësojnë dhe të paraqesin formularin e tyre PLF (Formulari i Lokatorit të Pasagjerëve) dhe mund t'i nënshtrohen testimit të rastësishëm pas mbërritjes në kufirin Grek.

Për sa i përket kthimit në vendin e qëndrimit të përhershëm, do të zbatohen rregullat në fuqi me demonstrimin e E1 (dokumenti vjetor për deklarimin e vendbanimit dhe të ardhurave) dhe E9 (dokumenti vjetor për deklarimin e pasurisë).

Që nga 10 nëntori 2020, banorët e përhershëm të Greqisë që udhëtojnë me avion në vendet e huaja kërkohet të plotësojnë formularin elektronik PLF (Forma e Lokatorit të Pasagjerëve) me detajet e tyre të kontaktit në Greqi përpara nisjes nga Greqia dhe të tregojnë në pikën e kalimit të kufirit dëshmi të plotësimit të formularit elektronik PLF që automatikisht dërgohet me e-mail tek secili udhëtar në mënyrë elektronike.

Personat që dëshirojnë të udhëtojnë në Greqi duhet të jenë të vetëdijshëm se, që nga 20 mars 2021, Greqia mbetet në mbyllje kombëtare (lockdown) deri të hënën, datë 5 prill, orë 06:00. Ndalimi i udhëtimit ndë-rajonal në vend shtrihet gjithashtu deri të hënën, 5 prill dhe ora 06:00 në mëngjes si dhe ndalimi i lëvizjeve, me përjashtim arsyet 1.) punë, 2.) shëndet dhe 3.) shëtitje të kafshës shtëpiake, të grumbullimeve dhe trafikut natën, nga ora 21:00 deri në orën 05.00, ndërsa për zonat e konsideruara me nivel rreziku të lartë si Lesvo, Mikono, Santorini, Patra, Eordheo, Nea Propodidha, Thiva dhe Tanagra, Halkidha, Sparti, nga ora 18:00-05:00 (për Atikën ndalimi i lëvizjeve është 21:00-05:00 edhe pse konsiderohet zonë e kuqe). Më shumë informacion në lidhje me mënyrat e përshtatshme dhe mjetet e transportit dhe lejet e lëvizjes brenda Greqisë janë në dispozicion në: forma.gov.gr/

- **Gjeorgji**

Është e ndaluar hyrja për të huajt. Kërkohet Leje e veçantë. Ka karantinë të detyruar.

- **Gjermani**

1. Hyrja nga Shqipëria në Gjermani është e mundur për shtetasit shqiptarë që janë rezidentë në Gjermani si dhe për shtetasit shqiptarë që udhëtojnë në tranzit dhe ata që faktojnë arsye urgjente udhëtimi.
Për raste të jashtëzakonshme dhe kur kushtëzohet nga nevoja urgjente, secili rast për hyrje në Gjermani është kompetencë e oficerit të policisë kufitare i cili vlerëson rastin mbi baza individuale në momentin e inspektimit;
Në linkun e mëposhtëm gjeni një shpjegim të detajuar për arsyet e justifikuara të hyrjes në Gjermani.
https://www.bmi.bund.de/SharedDocs/faqs/EN/topics/civil-protection/coronavirus/travel-restrictions-border-control/travel-restriction-border-control-list.html#f14104798

Udhëzime:https://www.bundesgesundheitsministerium.de/fileadmin/Dateien/3_Downloads/C/Coronavirus/Infoblatt/2021/ALB_MB.pdf/

2. Shtetasit që hyjnë në Gjermani duhet të kenë një test negativ, të 48 orëve të fundit, të printuar ose
në një dokument elektronik në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht;
Nga 30 Mars 2021, të gjithë personat që udhëtojnë në Gjermani me avion duhet të paraqesin një rezultat negativ të testit COVID-19 përpara se të fillojnë udhëtimin e tyre. Kjo vlen pavarësisht nga vendi nga ku individi ka udhëtuar dhe gjithashtu për pasagjerët që përshkojnë vetëm Gjermaninë (d.m.th. për tranzit ndërkombëtar). Personat nën moshën gjashtë vjeç dhe ekuipazhet e avionëve përjashtohen.
Rezultati negativ i testit duhet t'i paraqitet linjës ajrore përpara nisjes.Rezultati i testit duhet të mbahet për të paktën dhjetë ditë pas hyrjes dhe t'i paraqitet autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

3. Regjistrimi digjital i shtetasve shqiptarë para hyrjes;
Udhëtarët që kanë vizituar një zonë rreziku, një zonë me incidencë të lartë ose një zonë të variantit të virusit në dhjetë ditët e fundit para se të hyjnë në Gjermani duhet të regjistrohen në www.einreiseanmeldung.de para se të mbërrijnë në Gjermani dhe të mbajnë me vete provën e regjistrimit kur të hyjnë.
Nëse nuk arrijnë që të regjistrohen në linkun e mësipërm, shtetasit shqiptarë mund të plotësojnë një formular zëvendësues që shkarkohet në linkun e mëposhtëm:
https://www.bundesgesundheitsministerium.de/fileadmin/Dateien/3_Downloads/C/Coronavirus/Infoblatt/2021/DEU.pdf

Këtu do të gjeni përgjigje për aspektet e regjistrimit digjital: https://www.bundesgesundheitsministerium.de/fileadmin/Dateien/3_Downloads/C/Coronavirus/DEA/AL_FAQ_DEA.pdf/

4. Detyrimi i shtetasve shqiptarë për të bërë 10 ditë karantinë në Gjermani;

Pas hyrjes në Gjermani pas një qëndrimi në një zonë rreziku, zonë me incidencë të lartë ose zonë të variantit të virusit brenda dhjetë ditëve të fundit, shtetasit duhet:
-) të regjistrohen në www.einreiseanmeldung.de para se të hyjnë në vend dhe të mbajnë me vete dëshmi për regjistrim;
-) të testohen për infeksion me koronavirusin SARS-CoV-2 para ose menjëherë pas hyrjes në vend;
-) të vazhdojnë drejtpërdrejt në destinacionin e tyre pas hyrjes dhe të vetë-izolohen atje për dhjetë ditë (karantinë).
Në Gjermani landet janë përgjegjëse për rregulloret e veçanta të karantinës.Duke futur kodin postar të destinacionit, shtetasit shqiptarë mund të gjejne informacionin e kontaktit të zyrës kompetente shëndetësore duke përdorur faqen e internetit në vijim: https://tools.rki.de/PLZTool/en-GB

Bëjnë përjashtim nga karantina shtetasit që janë tranzit në Gjermani. Karantina dhjetë-ditore mundet të ndërpritet më herët pas ditës së pestë pas hyrjes me një rezultat negativ të testit për infeksion me koronavirus SARS-CoV-2, në përputhje me rregulloret e zbatueshme të vendeve.
5. Pas hyrjes në Gjermani mbajtja e maskës dhe distancës është detyrim.

Goja dhe hunda duhet të mbulohen brenda çdo transporti publik, në dyqane dhe vende të zëna në natyrë, ku distanca minimale nga të tjerët nuk mund të mbahet gjatë gjithë kohës. Maskat duhet të plotësojnë kërkesat e **FFP2**, **KN95 / N95 ose maska kirurgjikale**.
Nëse udhëtarët shfaqin simptoma të shoqëruara me COVID-19 (kollitje, rrjedhje hundësh, dhimbje fyti ose ethe) ata duhet të kontaktojnë me telefon me një mjek ose të kontaktojnë linjën telefonike 116 117.

Aplikacioni paralajmërues për Covid-19**:** https://www.corona-warn.app/en/

6.Infomacione për secilin land:

Baden-Vyrttembergu (Baden-Württemberg): https://www.baden-wuerttem-berg.de/en/service/aktuelle-infos-zu-corona/corona-information-in-other-languages/

- Bavaria (Bayern): https://www.bayern.de/coronavirus-in-bayern-informationen-auf-einen-blick/
- Berlini (Berlin): https://www.berlin.de/corona/en/
- Brandenburgu (Brandenburg): https://kkm.brandenburg.de/kkm/en/
- Bremeni (Bremen): https://www.bremen.eu/corona/
- Hamburgu (Hamburg): https://www.hamburg.com/resi-dents/settle/health/14111762/corona-whats-new/
- Heseni(Hessen):https://soziales.hessen.de/gesundheit/corona-in-hessen/themenbe-reich-quarantaene/quarantaene-bestimmungen-und-coronatests-fuer-einrei-sende/fremdsprachliche-informationen-fuer-einreisende-aus-risikogebieten/
- Meklenburg-Pomerania Perëndimore (Mecklenburg-Vorpommern): https://www.regie-rung-mv.de/corona/
- Saksonia e Poshtme (Niedersachsen): https://www.niedersachsen.de/Coronavirus/infor-mationen_in_fremdsprachen/informationen-in-fremdsprachen-186959.html/
- Rini Verior-Vestfalia (Nordrhein-Westfalen): https://www.land.nrw/corona-multilingual/
- Rajnland-Pfalci (Rheinland-Pfalz): https://corona.rlp.de/de/service/information-in-your-language/
- Landi i Zarës (Saarland): https://www.saarland.de/DE/portale/corona/faq/fremdspra-chen/englisch/englisch.html/
- Saksonia (Sachsen): https://www.coronavirus.sachsen.de/wir-gegen-corona-8251.html#a-8755/
- Saksoni-Anhalti (Sachsen-Anhalt): https://ms.sachsen-anhalt.de/themen/gesundheit/ak-tuell/coronavirus/mehrsprachige-informationen/

- Shlesvig-Holshtajni (Schleswig-Holstein): https://www.schleswig-holstein.de/DE/Landes-regierung/VIII/_startseite/Artikel_2020/_Informationen_Urlauber/Downloads/in-foblatt_reiserueckkehrer_AL.html/

 Tyringia (Thüringen): https://corona.thueringen.de/

- **Holanda**

Qeveria e Holandës ka marrë masë shtesë për të reduktuar udhëtimet ndërkombëtare, për shkak të shfaqjes dhe përhapjes së mutacioneve të reja të Covid-19. Nga data 3 mars 2021, udhëtarët që duan të shkojnë në Holandë, nëpërmjet linjave ajrore, duhet të plotësojnë, një nga dy kushtet e mëposhtme:

- Të kenë një certifikatë testi negativ të testimit të amplifikimit nukleid-acid (PCR ose teste të tjera si POCT, NAAT, RTPCR, LAMP dhe TMA), që është kryer, më herët se 12 orë nga nisja e fluturimit.
- Të dëshmojnë një certifikatë testi negativ NAAT, që është bërë të paktën 72 orë përpara mbërritjes në Holandë dhe një rezultat negativ testimi të shpejtë, (rapid test, antigjen), të kryer më pak se 4 orë para fluturimit.
- Këto rregulla do të zbatohen rrjedhimisht edhe për shtetasit shqiptarë.
- Ndër kategoritë të cilat përjashtohen nga paraqitja e testit PCR dhe testit të shpejtë janë diplomatët dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike.
- Të gjitha udhëtimet të cilat nuk konsiderohen thelbësore drejt Holandës nuk lejohen aktualisht dhe pa përjashtime, udhëtarët të cilët nuk provojnë dot arsyen e domosdoshme të udhëtimit, nuk do të pranohen të hyjnë në territorin e Holandës.

Gjithashtu, ka dhe disa kritere të tjera që aplikohen për udhëtimet drejt Holandës. Njoftohen autoritetet lokale në Shqipëri dhe qytetarët, të ndjekin këtë link, me informacion më të hollësishme, mbi kriteret/procedurat e reja që duhen zbatuar.

https://www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/visiting-the-netherlands-from-abroad/checklist/

- Të gjitha dyqanet dhe qendrat tregtare mbyllen, me përjashtim të marketeve dhe farmacive;
- Restorantet, kafenetë dhe baret vazhdojnë të mbyllura;
- Nuk lejohet lëvizja në rrugë nga ora 21:00 darkës deri në orë 04:30 të mëngjesit
- Lejohet vetëm akomodimi në hotele dhe është pezulluar shërbimi në dhomë dhe shërbime të tjera nga subjektet hoteliere;
- Mbajtja e maskave nga të gjithë qytetarët në çdo mjedis të populluar publik (supermarkete dhe mjedise të tjera të mbyllura) është e detyrueshme.

https://www.government.nl/latest/news/2020/08/18/let-s-keep-coronavirusout

•Lista e zonave të rrezikut COVID përshtatet pasi rrethanat ndryshojnë dhe informacioni vihet në dispozicion: www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/tackling-new-coronavirus-in-the-netherlands/travel-and-holidays/self-quarantine

Përveç kësaj, gjithashtu janë theksuar në mënyrë specifike këshilla individuale për udhëtime për secilin vend nëse kërkohet vetë-karantinë:
https://www.nederlandwereldwijd.nl/reizen/reisadviezen:>/

Për të ndihmuar në parandalimin e infeksioneve të mëtejshme, të gjithë me simptoma duhet të qëndrojnë pranë shtëpisë ose në akomodimin e tyre dhe të testohen:
www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/coronavirus-test/

Emërimet për testim mund të bëhen duke telefonuar 0800 1202 (ose +31 850 659063 nga një telefon jo-Hollandez) ose në internet përmes
www.government.nl/coronavirustest/

Informacion i përgjithshëm
Si përfundim, Ministria do të donte të tërhiqte vëmendjen në faqet e internetit më poshtë:
• Masat mbarë kombëtare që janë krijuar për të rivendosur kontrollin mbi koronavirusin:
www.government.nl/latest/news/2020/08/06/regainingcontrol-over-coronavirus-with-local-measures./
• Masa shtesë lokale mund të zbatohen në qytete dhe rajone të caktuara, për shembull në Amsterdam:
www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/tourism-in-thenetherlands/

• Tema të ndryshme për qasjen Hollandeze:
www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/

• Rregullat themelore të azhornuara për të rivendosur kontrollin e virusit:
www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/tackling-new-coronavirusin-the-netherlands/basic-rules-for-everyone/

• Udhëtimi për në Holandë:
www.netherlandsandyou.nl/travel-andresidence/visas-for-the-netherlands/qas-travel-restrictions-for-thenetherlands/

- **Hungari**

Hyrja, qëndrimi apo kalimi transit në Hungari vazhdojnë të jenë të kushtëzuara si pasojë e situatës së shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

Në Hungari lejohen të hyjnë për të qëndruar apo kaluar tranzit ata shtetas që zotërojnë:

- Pasaportë hungareze ose të një shteti tjetër të zonës Schengen;
- Leje qëndrimi hungareze ose të një shteti tjetër të zonës Schengen;
- Vizë pune hungareze ose të një shteti tjetër të zonës Schengen.

Shtetasit e tjerë, që nuk zotërojnë asnjë nga dokumentet e lart përmendura, mund të hyjnë në Hungari vetëm nëse marrin një leje të posaçme hyrjeje nga policia hungareze. Aplikimi për këtë leje mund të bëhet online në faqen e internetit të policisë hungareze në linkun e mëposhtëm:

https://ugyintezes.police.hu/en/uj-ugy-inditasa

Brenda 24 orësh policia hungareze kthen përgjigje nëpërmjet emailit me vendimin e marrë i cili lejon ose jo hyrjen e personit në Hungari. Nëse vendimi është pozitiv, përgjigja e printuar, së bashku me dokumentat mbështetëse duhet t'i paraqiten autoriteteve hungareze në kufi. Dokumentat mbështetëse duhet të jenë origjinale dhe jo fotokopje apo të printuara.

Për këtë leje hyrjeje mund të aplikojnë vetëm ata persona që kërkojnë të hyjnë dhe qëndrojnë në territorin hungarez. Pas hyrjes në Hungari, është i detyrueshëm vetëkarantinimi 10-ditor. Qytetarët që kërkojnë të kalojnë tranzit në Hungari nuk janë subjekt i lejeve nga policia hungareze. Ata mund të kalojnë tranzit në Hungari vetëm nëse zotërojnë një nga dokumentat e lartpërmendura.

Ndërkohë, transporti i mallrave mbetet i hapur për ato subjekte që zotërojnë një licensë ndërkombëtare të transportit të mallrave.

- **Irlandë**

Bazuar në legjislacionin irlandez, pasagjerët nga një numër i caktuar vendesh, do të duhet të paraqesin test negativ PCR dhe të kryejnë karantinë në hotel, pas mbërritjes në Irlandë. Kjo listë përcaktohet në bazë të incidencës së rasteve me Covid-19 për 100 mijë banorë, krahasuar me nivelet e incidencës në Irlandë dhe mbi masat e përgjithshme të marra mbi pandeminë në nivel global. Këto vende përfshihen në listën e cilësuar "Kategoria 2". Këtu futet dhe Shqipëria, bashkë me disa vende të tjera të Evropës. Çdo person që udhëton nga Shqipëria në Irlandë ose kryen tranzit nëpërmjet Shqipërisë, është i detyruar ligjërisht të kryejë karantinë 14 ditore në hotel, pas mbërritjes në Irlandë. Ekziston mundësia e daljes nga karantina nëse kryejnë test PCR dhe rezultojnë negativë në ditën e 12-të.

Këto masa aplikohen për të gjithë udhëtarët, që hyjnë në Irlandë nga data 6 prill, ora 04:00.

Të gjithë udhëtarët, me pak përjashtimë të limituara, (përfshirë diplomatët) që vijnë driekt nga Shqipëria ose kryjenë tranzit nëpërmjet Shqipërisë, duhet të rezervojnë dhe paguajnë hotelin në avancë, para udhëtimit drejt Irlandës, bazuar në legjislacionin irlandez.

- **Islandë**

Kufizimet e udhëtimit zbatohen për të gjithë shtetasit e vendeve të treta, d.m.th. personat që nuk janë as shtetas të vendeve të ZEE / EFTA, apo shtetas të Andorrës, Monakos, San Marinos ose Vatikanit - pavarësisht faktit nëse duhet të udhëtojnë më vizë, ose u lejohet udhëtimi brenda hapësirës Schengen.

Të gjithë ata që vijnë nga vendet ku norma e infektimit me COVID-19 për 14 ditë e tejkalon 500 për 100,000 banorë, kërkohet të qëndrojnë në mjediset qeveritare të karantinës gjatë karantinës, ose nëse ata duhet t'i nënshtrohen izolimit për shkak të infeksionit.

Kjo vlen për të gjitha zonat e përcaktuara nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve si e kuqe e errët (në link-un më poshtë informacioni i plotë). Qëndrimi në mjediset e karantinës është pa pagesë. Këto rregulla janë në fuqi deri në fund të Prillit.

Të gjithë që udhëtojnë në Islandë duhet:

· Të regjistrohen paraprakisht, regjistrimi paraprak nuk përbën një autorizim udhëtimi;

· Të paraqisni një certifikatë të testit negativ PCR për COVID-19 (SARS-CoV-2) përpara se të hipni në një avion ose anije për në Islandë dhe kur të mbërrini. Rezultati negativ i testit duhet të jetë jo më shumë se 72 orë para nisjes (në pjesën e parë të udhëtimit). Testet e shpejta të antigjenit nuk janë të vlefshme. Certifikata duhet të dorëzohet në Islandisht, Norvegjisht, Suedisht, Danisht ose Anglisht. Certifikatat në gjuhë të tjera nuk konsiderohen të vlefshme. Rezultatet e testit duhet të regjistrohen paraprakisht. Pa një test negativ PCR do t'ju refuzohet hyrja në kufi.

· Duhet të bëni dy teste për të parë praninë e Covid-19, pas mbërritjes në Islandë, me një periudhë karantine të detyrueshme 5-6 ditore, ndërmjet dy testeve. Testet janë pa pagese. Nuk ka përjashtim nga ky rregull.

· Të gjithë udhëtarëve u rekomandohet të shkarkojnë aplikacionin: Ranking C-19.

Detyrimi juaj është të keni një informacion të plotë, prandaj për lutemi të përditësoheni vazhdimisht mbi masat e marra në këtë link: https://www.covid.is/sub-categories/visiting-iceland

- **Itali**

Informohen bashkatdhetarët se sipas Dekretligjit të Qeverisë italiane, me nr. 30, datë 13 mars 2021, duke filluar nga sot, datë 15 mars 2021, është urdhëruar një bllokim i ri i të gjithë territorit italian, i vlefshëm deri më datë 6 prill 2021. Lidhur me masat e reja, Qeveria italiane ka përditësuar listën e pyetje-përgjigjeve më të shpeshta mbi kushtëzimet e vlefshme për periudhën 15.03.2021 - 06.04.2021. Konsultoni në vijim linkun zyrtar: http://www.governo.it/…/domande-frequenti-sulle-misur…/15638

Për qytetarët shqiptarë:

Udhëtimet Shqipëri – Itali (dhe anasjelltas) lejohen vetëm për arsye të përcaktuara, si: arsye pune, shëndetësore, studimi, urgjence absolute, kthim në banesë apo vendbanim. Nuk lejohen udhëtimet për turizëm. Lejohet gjithmonë kthimi, në Itali nga Shqipëria, i shtetasve italianë/ BE/ Shengen dhe i familjarëve të tyre, si edhe i shtetasve të pajisur me leje të rregullt qëndrimi. Në momentin e kthimit në Itali, shtetasi duhet të vetë-karantinohet si edhe t'i nënshtrohet mbikëqyrjes shëndetësore, të plotësojë një vetëdeklarim në të cilin të paraqesë arsyen e cila e lejon të kthehet në Itali dhe të arrijë në vend-mbërritjen e tij përfundimtare në Itali vetëm me mjet privat.

-Personel shëndetësor i cili hyn në Itali për të ushtruar profesionin e tij, përfshirë ushtrimin e përkohshëm të profesionit të parashikuar nga neni 13 i Ligjit nr. 18, datë 17 mars 2020;

-Punonjës ndërkufitarë në hyrje dhe në dalje nga territori italian për arsye pune të provuara dhe që kthehen në banesën, vendqëndrimin apo vendbanimin e tyre;

-Personel i shoqërive dhe subjekteve me seli ligjore apo dytësore në Itali që udhëton jashtë Italisë për arsye të provuara pune për një afat kohor jo më të gjatë se 120 orë;

-Funksionarë dhe agjentë, gjithsesi të përcaktuar, të Bashkimit Evropian apo të organizatave ndërkombëtare, diplomatë, personel administrativ dhe teknik i misioneve diplomatike, funksionarë dhe nëpunës konsullorë, personel ushtarak në ushtrim të detyrave të tyre; -Nxënës dhe studentë të cilët ndjekin studimet në një shtet të ndryshëm nga ai në të cilin banojnë apo kanë vendbanimin, në të cilin kthehen çdo ditë apo të paktën një herë në javë. Studentët, të cilët duhet të testohen për pranimin në kurset universitare apo për gjuhën, mund të hyjnë në Itali duke paraqitur vetëdeklarimin si edhe një dokument që provon pjesëmarrjen në testim. Natyrisht, hyrja në Itali duhet të bëhet afër datës së testimit dhe qëndrimi në territorin italian nuk mund të zgjatet përtej kohës së domosdoshme.
-Nuk janë të detyruar të vetë-karantinohen dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes shëndetësore, gjithashtu: ekuipazhet e mjeteve të transportit, personeli i mjeteve të udhëtimit, shtetasit të cilët hyjnë në Itali për arsye pune, të rregulluara nga protokolle të posaçme sigurie, të aprovuara nga autoritetet kompetente shëndetësore.

-Rekomandohet që gjithmonë të konsultoheni përpara udhëtimit në faqen ViaggiareSicuri, për t'u njohur me kushtet shtesë specifike që rajone të ndryshme të Italisë mund të vendosin në bazë të normativave në fuqi.

Për më shumë informacion, lutemi konsultoni linkun me poshtë:
https://www.esteri.it/mae/it/ministero/normativaonline/decreto-iorestoacasa-domande-frequenti/focus-cittadini-

italiani-in-rientro-dall-estero-e-cittadini-stranieri-in-italia.html/

- **Izrael**

Shtetasit shqiptarë udhëtojnë pa vizë në Izrael për një periudhë qëndrimi 90 ditë në 180.

Në kuadrin e situatës pandemike, janë pezulluar udhëtimet në Izrael për qëllime turistike. Lejohen vetëm kategori të caktuara qytetarësh të udhëtojnë në drejtim të Izraelit, nëse kanë dokumenta izraelite, kartë identiteti izraelite, vizë qëndrimi afatgjatë, vizë studentore etj të cilët janë në gjendje të argumentojnë se udhëtimi kryhet për arsye urgjente, mjekësore, pune etj. Leja per te hyre ne Izrael aplikohet nepermjet link-ut
Apply online for foreign nationals coming to Israel
https://govforms.gov.il/mw/forms/EntryRequest@morc.gov.il

Për të udhëtuar në Izrael aplikohen rregullat si vijon:

Për të hyrë në Izrael kërkohet një test PCR negative i kryer Brenda 72 orëve nga nisja. Një certifikatë shëndetësore e cila duhet të kryhet on line 24 orë para nisjes, në linkun inbound clearance application" https://www.gov.il/en/service/request-entry-to-israel-covid19/

Për te dale nga Izraeli duhet te plotësohet online formulari qe gjendet ne link:

https://www.gov.il/en/service/request-depart-from-israel-covid19?utm_source=go.gov.il&utm_medium=referral

Për më shumë informacion lutemi te konsultohet faqja zyrtare e Ministrisë së Shëndetësisë e Izraelit:
> Israeli Ministry of Health Air travel to and from Israel | COVID-19 Air Transport (www.gov.il)

- **Japonia**

Për momentin, Japonia ka pezulluar hyrjen në këtë shtet për të gjithë shtetasit e huaj, qoftë turistë apo biznesmenë.

- **Jemen**

Për shkak të pasigurisë së theksuar si pasojë e situatës së COVID-19, konfliktit të armatosur, territoreve të minuara, kryengritjeve civile dhe sistemit shëndetësor të rënduar, shumica e vendeve nuk e rekomandojnë udhëtimin e qytetarëve të tyre në Jemen.

- **Kanada**

"Kanadaja vijon të ndalojë hyrjen e shtetasve të huaj me disa përjashtime si: anëtarët e familjes së ngushtë të shtetasve kanadezë ose të rezidentëve të përhershëm; anëtarët e familjes së gjerë të shtetasve kanadezë ose të rezidentëve të përhershëm; persona të autorizuar nga Agjencia e Shëndetit Publik të Kanadasë për të udhëtuar në Kanada për arsye humanitare; diplomatët dhe familjarët e tyre të akredituar; etj. Të gjitha kategoritë e lejuara dhe kriteret plotësuese për secilën prej tyre janë të përcaktuara qartësisht dhe në detaje nga autoritetet kanadeze të publikuara në faqen zyrtare të IRCC.

Shtetasve të cilëve u lejohet hyrja në Kanada, përfshirë ata kanadezë, kanë detyrimin e paraqitjes së testit negativ PCR COVID-19 në mbërritje dhe bërjes së testit PCR përpara se të dalin nga aeroporti. Ata kanë gjithashtu detyrimin e karantinimit për 14 ditë nga hyrja në territorin e Kanadasë edhe nëse janë vaksinuar për COVID-19

apo testuar negativ për COVID-19 apo rikuperuar nga COVID-19. Periudha e karantinës përfshin akomodimin e detyrueshëm të parapaguar prej tre (3) netësh në një hotel të autorizuar nga qeveria kanadeze në kosto të udhëtarit. Më tepër detaje mbi karantinimin gjenden këtu.
Informacion e detaje të përditësuara sa i përket hyrjes në territorin e Kanadasë gjenden në këtë lidhje."

- **Katar**

Duke filluar nga data 26 mars 2021, Kabineti qeveritar i Katarit vendosi masa të reja kufizuese për përballimin e përhapjes se pandemisë COVID-19.
Këto masa kanë të bëjnë kryesisht me uljen e personelit të angazhuar në administratën publike por edhe ne atë private.
Për sa i përket rregullave të udhëtimit, masat e marra më parë nuk ndryshojnë.
Për të hyre ne Katar qytetari Katarian apo Rezidenti ne Katar duhet te paraqesë Testin negativ PCR te bere deri 48 ore para mbërritjes, ne rast te mungesës se Testit udhëtari detyrohet te beje testin ne Aeroportin mbërritës, test qe do te përsëritet ne ditën e 6-te pas mbërritjes. Para udhëtimit qytetaret qe udhëtojnë për ne Katar duhet te bëjnë rezervimin ne një hotel për karantinim një javor (rezervimi hotelit behet ne portalin Discover Qatar). Nga karantinimi ne hotel përjashtohen qytetaret katarian te cilët e kryejnë karantinën ne shtëpitë e tyre. Rezidentet ne katar duhet patjetër te bëjnë rezervimin ne hotel, edhe për ketë kategori përjashtohen udhëtaret qe vine nga shtetet e Green List Countries, liste qe përditësohet vazhdimisht dhe gjendet ne portalin Discover Qatar.
Nga karantinimi përjashtohen gjithashtu trupi diplomatik dhe familjaret e tyre. Karantinimi njëjavor i tyre behet ne rezidencat e tyre. Testi ne aeroport dhe ne ditën e 6-te pas mbërritjes është i detyrueshëm edhe për ketë kategori.

- **Kazakistan**

Për shkak se Kazakistani ende nuk ka rinisur fluturimet me shumë vende, është e ndaluar hyrja për të huajt. Hyrja realizohet vetëm me leje të posaçme nga Kryeministria e vendit.Nuk ka karantinë. Kusht është testi negativ i PCR i 48 orëve të fundit.

- **Kinë**

1. Situata aktuale e pandemisë Covid-19 është ende serioze, gjë e cila rrit rrezikun e infektimit gjatë udhëtimit përtej kufirit. Këshillohet të mos udhëtoni, nëse është e shmangshme.

2. Meqenëse nuk ka fluturim direkt nga Shqipëria në Kinë, duke filluar nga data 21 Shkurt 2021, pasagjerët kinezë dhe të huaj, në rast se nuk mund të shmangin udhëtimin për në Kinë, duhet të arrijnë në Kinë nëpërmjet vetëm një ndalese, për të shmangur rrezikun e lartë të infektimit gjatë udhëtimit nëpërmjet disa shteteve, dhe të japin itinerarin e plotë dhe lejen e qëndrimit në Shqipëri për të aplikuar për Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklarimit të Shëndetit.

Ambasada e Republikës Popullore të Kinës në Republikën e Shqipërisë nuk do të lëshojë Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklarimit të Shëndetit për pasagjerët që nuk përmbushin kërkesat e sipërpërmendura.

3. Kërkesat për pasagjerët që nisen nga Shqipëria duke udhëtuar drejt një shteti të tretë me automjet, traget etj. dhe pastaj tranzit për në Kinë janë të njëjta me ato të pasagjerëve që udhëtojnë nga ajri. Pasagjerët duhet të kryejnë testin e acidit nukleik dhe testin IgM të anti-trupave, në Shqipëri dhe në shtetin tranzit, dhe të aplikojnë për Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklarimit të Shëndetit respektivisht.

4. Sipas protokollit të Diagnostikimit dhe Trajtimit të COVID-19 (Botimi Pilot VIII), pasagjerët e diagnostikuar me Covid-19 ose pasagjerët e pa diagnostikuar por që rezultojnë pozitiv në ndonjë prej

testeve të acidit nukleik, IgM ose IgG (me përjashtim të pasagjerëve që rezultojnë pozitiv me anti-trupa IgM ose IgG nga vaksinimi ndaj Covid-19), duhet të dorëzojnë certifikatë diagnostikimi me konkluzionin nga kontrolli i mushkërive nëpërmjet X-Ray ose CT Scan dhe certifikatë me rezultat negativ të dy testeve rresht të acidit nukleik (intervali midis dy testeve nuk duhet të jetë më i shkurtër se 24 orë).

Aplikuesit duhet të deklarojnë me vërtetësi historinë e tyre mjekësore dhe rezultatet e testeve. Certifikuar nga Ambasada Kineze në Shqipëri, aplikuesit që ndodhen në situatën e sipërpërmendur duhet t'i nënshtrohen karantinës 14 ditore dhe monitorimit të shëndetit. Ata do të pajisen me Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklarimit të Shëndetit nëse çdo gjë është normale gjatë monitorimit të shëndetit dhe të dorëzojnë certifikatë me rezultat negativ të testit të acidit nukleik dhe testit IgM të anti-trupave, testet të cilat duhet të jenë brenda 48 orëve para fluturimit.

5. Aplikuesit duhet të njihen me kërkesat për të aplikuar për Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklaratës së Shëndetit nga Ambasada/Konsullata Kineze në shtetin tranzit para se të aplikojnë në Ambasadën Kineze në Shqipëri, për të shmangur bllokimin në udhëtim.

Me qëllim reduktimin e transmetimit të Covid-19 përtej kufirit, të gjithë pasagjerëve kinezë dhe të huaj që fluturojnë nga Shqipëria për në Kinë, do t'ju kërkohet të bëjnë testin e Acidit Nukleik dhe testin e anti-trupave IgM dhe pastaj të aplikojnë për kodin jeshil të shëndetit me shenjën 'HS' (referuar më poshtë Kodi HS) ose për Formularin e Deklarimit të Shëndetit të certifikuar në formën e kodit QR me shenjën "HDC" (referuar më poshtë Kodi HDC), para fluturimit. Kërkesat specifike janë si më poshtë:

I. Kërkesat për testim

Pasagjerët që nisen nga Shqipëria në Kinë nëpërmjet fluturimeve lidhëse nga një shtet i tretë, duhet të kryejnë edhe testin e acidit nukleik edhe testin e anti-trupave IgM, në Shqipëri dhe në shtetin tranzit.

1. Pasagjerët duhet të bëjnë testin e acidit nukleik dhe testin e anti-trupave IgM në laboratorët e njohur nga Ambasada e Republikës Popullore të Kinës në Republikën e Shqipërisë brenda 48 orëve para fluturimit për në shtetin tranzit dhe të aplikojnë në Ambasadën Kineze për kodin HS ose kodin HDC duke dorëzuar rezultate negativ për të dy testet.

2. Pasagjerët duhet të kryejnë testin e acidit nukleik dhe testin e anti-trupave IgM përsëri në shtetin transit brenda 48 orëve para fluturimit për në Kinë dhe të aplikojnë në Ambasadën/Konsullatën Kineze në shtetin transit për kodin HS ose kodin HDC duke dorëzuar rezultate negativ për të dy testet.

3. Vlefshmëria e testit të acidit nukleik dhe testit të anti-trupave IgM është 48 orë që nga momenti i marrjes së mostrës, p.sh. nëse mostra merret në datë 8 Shkurt, rezultati i testit do të jetë i vlefshëm deri në datë 10 Shkurt (përfshihet).

II. Pasagjerët kinezë që aplikojnë për Kodin Jeshil të Shëndetit me shënjën 'HS'

Pasagjerët kinezë duhet të deklarojnë gjendjen e tyre shëndetësorë dhe të ngarkojnë në kohë foto të certifikatave të rezultateve negative të testeve të acidit nukleik dhe të anti-trupave IgM, itinerarin e plotë dhe lejen e qëndrimit nëpërmjet aplikacionin Health Code në WeChat. Kodi jeshil HS do të lëshohet pas verifikimit nga Ambasada Kineze në Shqipëri. Pasagjerët duhet të paraqesin kodin jeshil HS të lëshuar nga Ambasada/Konsullata Kineze në shtetin transit brenda periudhës së vlefshmërisë para hipjes në avion për në Kinë.

III. Pasagjerët e huaj që aplikojnë për të certifikuar Formularin e Deklarimit të Shëndetit (Health Declaration Form)

Pasagjerët e huaj që udhëtojnë nga Shqipëria për në Kinë duhet të paraqesin Formularin e Deklarimit të Shëndetit të certifikuar, para nisjes së fluturimit. Ata mund të aplikojnë për certifikimin e Formularit të Deklarimit të Shëndetit në faqen e internetit https://hrhk.cs.mfa.gov.cn/H5/ nëpërmjet kompjuterit ose celularit, të japin informacionin e nevojshëm, të deklarojnë gjendjen shëndetësorë dhe të ngarkojnë rezultatet e testeve, itinerarin e plotë dhe lejen e qëndrimit në Shqipëri (vetëm për shtetasit jo-shqiptarë). Pasi Ambasada Kineze në Shqipëri të ketë shqyrtuar dhe verifikuar dokumentet, do të lëshojë Formularin e Deklaratës së Shëndetit të certifikuar në formën e kodit QR me shenjën HDC, nëpërmjet të njëjtës faqe interneti. Pasagjerët duhet të paraqesin kodin jeshil HDC ose në version elektronik ose të printuar brenda vlefshmërisë në mënyrë që të lejohen të nisen.

IV. Kujtesë

1. Ju lutemi, lexoni dhe ndiqni kërkesat me kujdes. Nëse nuk merrni kodin jeshil HS ose Kodin HDC me rezultatet negative të testit të acidit nukleik dhe të anti-trupave IgM, do të thotë se ju nuk kualifikoheni për tu nisur për fluturimin në Kinë dhe do të duhet të ndryshoni itinerarin tuaj.

2. Meqenëse nuk ka fluturim direkt midis Shqipërisë dhe Kinës, pasagjerët kinezë dhe të huaj, në rast se nuk e shmangin dot fluturimin për në Kinë, duhet të arrijnë në Kinë nëpërmjet vetëm një ndalese, për të shmangur rrezikun e lartë të infektimit gjatë udhëtimit nëpërmjet disa shteteve, dhe të japin itinerarin e plotë dhe lejen e qëndrimit në Shqipëri për të aplikuar për kodin HS ose HDC. Ambasada Kineze në Shqipëri nuk do të lëshojë kodin HS apo HDC në rast se pasagjerët nuk plotësojnë kërkesat e sipërpërmendura.

3. Kërkesat për pasagjerët që nisen nga Shqipëria duke udhëtuar drejt një shteti të tretë me automjet, traget etj. dhe pastaj tranzit për në Kinë janë të njëjta me ato të pasagjerëve që udhëtojnë nga ajri. Pasagjerët duhet të kryejnë testin e acidit nukleik dhe testin IgM të anti-trupave, në Shqipëri dhe në shtetin tranzit, dhe të aplikojnë për Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklarimit të Shëndetit respektivisht.

4. Ju lutemi të zgjidhni me kujdes rrugën e fluturimit për në Kinë dhe të njiheni me kërkesat për të aplikuar për Kodin Jeshil të Shëndetit ose Formularin e Deklaratës së Shëndetit nga Ambasada/Konsullata Kineze në shtetin tranzit për të shmangur rrezikun e infektimit apo bllokimin për shkak të mos hyrjes dot në shtetin tranzit, mos kryerjes së testit apo përfitimit të Kodit Jeshil të Shëndetit apo Formularit të Deklaratës së Shëndetit të certifikuar.

5. Sipas Protokolit të Diagnostikimit dhe Trajtimit të COVID-19 (Botimi Pilot VIII), pasagjerët e diagnostikuar me Covid-19 ose pasagjerët e pa diagnostikuar por që rezultojnë pozitiv në ndonjë prej testeve të acidit nukleik, IgM ose IgG (me përjashtim të pasagjerëve që rezultojnë pozitiv me anti-trupa IgM ose IgG nga vaksinimi ndaj Covid-19), duhet të dorëzojnë certifikatë diagnostikimi me konkluzionin nga kontrolli i mushkërive nëpërmjet X-Ray ose CT Scan dhe certifikatë me rezultat negativ të dy testeve rresht të acidit nukleik (intervali midis dy testeve nuk duhet të jetë më i shkurtër se 24 orë).

Aplikuesit duhet të deklarojnë me vërtetësi historinë e tyre mjekësore dhe rezultatet e testeve. Certifikuar nga Ambasada Kineze në Shqipëri, aplikuesit që ndodhen në situatën e sipërpërmendur duhet t'i nënshtrohen karantinës 14 ditore dhe monitorimit të shëndetit. Ata do të pajisen me Kodin HS ose HDC nëse çdo gjë është normale gjatë monitorimit të shëndetit dhe të dorëzojnë certifikatë me rezultat negativ të testit të acidit nukleik dhe testit IgM të anti-trupave, testet të cilat duhet të jenë brenda 48 orëve para fluturimit.

6. Pasagjerët duhet të deklarojnë me vërtetësi informacionin e tyre personal dhe të japin teste të vërteta dhe të vlefshme të acidit nukleik dhe të anti-trupave IgM. Pasagjerët që do të zbulohen se kanë fshehur me qëllim gjendjen e tyre shëndetësorë ose që kanë falsifikuar rezultatet e testeve do të mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

7. Ju lutemi mbani vëmendje në faqet zyrtare të internetit të Ambasadës Kineze në Shqipëri për informacion të përditësuar.

Për çështje urgjente në lidhje me testet, ju lutem gjeni kontaktet e Ambasadës si më poshtë:

Email: consulate_alb@mfa.gov.cn ; **Tel**: 00355-4-2232385 00355-692088899

- **Kili**

Hyrja në Kili është e ndaluar për shtetasit e huaj që kanë qenë në Mbretërinë e Bashkuar në 14 ditët e fundit para mbërritjes në Kili. Shtetasit e huaj jo-rezidentë mund të hyjnë në Kili vetëm përmes aeroportit të Santiagos. Kushdo që dëshiron të hyjë në Kili kërkohet të paraqesë një test PCR të bërë maksimumi 72 orë para se të hipë në fluturimin e drejtpërdrejtë për në Kili. Kërkohet sigurim shëndetësor që mbulon shpenzimet e Covid-19 me një minimum prej 30.000 USD (vetëm për të huajt jo-rezidentë) dhe të plotësohet një formular në: https://www.c19.cl/

- **Kolumbi**

Hyrja në Kolumbi është e ndaluar për shtetasit e huaj që kanë qenë në Mbretërinë e Bashkuar ose Brazil në 14 ditët e fundit para mbërritjes në Kolumbi. Kushdo që dëshiron të hyjë në Kolumbi kërkohet të paraqesë një provë PCR të bërë maksimumi 96 orë para imbarkimit. Është e nevojshme të plotësohet formulari si në linkun: https://apps.migracioncolombia.gov.co/pre-registro/public/preregistro.jsf/

- **Kosova**

Qytetarëve të Republikës së Shqipërisë që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, nuk i kërkohet testi për COVID-19. Vendimi i Qeverisë së Kosovës është i bazuar në parim të reciprocitetit. Si rrjedhojë, nuk kërkohen testime nga qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë dhe as nga bashkëqytetarët nga Lugina e Preshevës.

1. Qytetarët e huaj që hyjnë në Kosovë, përfshirë edhe ata me leje qëndrim të përkohshëm ose përhershëm në Kosovë, që vijnë nga vendet me risk të lartë sipas listës zyrtare të ECDC-së, duhet të kenë test RT-PCR negativ për Covid-19 të bërë në 72 orët e fundit, në bazë të parimit të reciprocitetit.
2. Përjashtim nga pika 1 më lartë bëjnë:
2.1. Nëse qytetari i huaj hynë në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohet nga Kosova brenda 3 ore përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruajnë deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda 3 ore;
2.2. Qytetarët e huaj që punojnë si transportues profesionistë (vozitësit), me kusht që të respektojnë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga Covid-19;
2.3. Qytetarët e huaj që kalojnë nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtare, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojnë territorin e Kosovës brenda 5 orësh;
2.4. Diplomatët e huaj të akredituar në Kosovë si dhe familjarët e tyre;
3. Për shtetasit e Kosovës që mund të hyjnë nga territori i RSh-së apo çdo vend tjeter drejt Kosovës për detyrimin e paraqitjes së testit negativ ose vetë izolimit 7 ditor. Përjashtim bëjnë ata që kanë dale 24 orët e fundit.

- ***Kufizime lokale:***

-Kufizimi i lëvizjes brenda Kosovës është nga ora 22:00 deri në orën 05:00.
-Ndalohen grumbullimet më shumë se 10 persona, seminaret, ahegjet, dasmat, homazhet apo mbledhjet .
-Transporti public deri 50% të kapaciteteve
-Qytetarët duhet të mbajnë maskë, përveç rasteve ku janë me familjarë në makinë, për vrap ose çiklizëm.
-Qëndrat tregtare dhe gastronomia, do jenë të mbyllura nga 07 deri në 18 prill, përveç shërbimeve esenciale: markete/farmaci.

- **Kroaci**

Kroacia ka vendosur zgjatjen e afatit kohor, deri me datë 15 Prill 2021, të rregullave kufizuese/ndaluese për udhetarët që hyjnë në Republikën e Kroacisë, si dhe vendosjen e disa kufizimeve të reja, përmes Vendimit të Qendrës së Mbrojtjes Civile Kroate.

Nga ky vendim përjashtohen:

1. Personat që vijnë drejtpërdrejt nga vendet dhe/ose rajonet e Bashkimit Evropian ose vendet dhe/ose rajonet e zonës Schengen dhe vendet e lidhura me zonën Schengen, të cilët janë në listën e gjelbër të Qendrës Evropiane të Kontrollit dhe Parandalimin e Sëmundjeve.
Këta shtetas, të cilët kanë kaluar tranzit nëpër vende/rajone të tjera pa ndalim, deri në pikat kufitare të Republikës së Kroacisë, duhet të provojnë në vendkalimin kufitar se nuk kanë qendruar në zonat e tranzitit dhe në atë rast do të lejohet kalimi i tyre në Republikën e Kroacisë.

2. Personat që nuk vijnë direkt nga vendet ose rajonet që janë në listën e gjelbër të Qendrës Evropiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Kroacisë, nëse:
- paraqesin një test negativ PCR për SARS-CoV-2, ose antigjen të shpejtë, renditur në listën e përbashkët të testeve të shpejta të antigjenit Covid-19, të njohura reciprocikisht nga vendet anëtare të BE-së dhe botuar nga Komisioni Evropian, duke patur parasysh që testi kryhet 48 orë para mbërritjes në pikën e kalimit kufitar. Nëse paraqitet testi i shpejtë i antigjenit dhe qëndrimi i synuar është më shumë se 10 ditë, duhet të kryhet një tesim tjetër jo më vonë se 10 ditë, pas datës së rezultatit të parë.
-paraqesin një certifikatë mjekësore vaksinimi që konfirmon se kanë kaluar 14 ditë nga doza e dytë ose në rast të vaksinave me një dozë të vetme, duke konfirmuar që kanë kaluar 14 ditë nga marrja e dozës.
- paraqesin një certifikatë mjekësore që janë rikuperuar nga sëmundja e Covid-19, një PCR test ose një test të shpejtë antigjeni pozitiv, duke konfirmuar se personi ka qenë i infektuar me Sars Cov-2, me specifikën që testi të jetë bërë brenda 180 ditëve të mëparshme dhe jo më vonë se 11 ditë para mbërritjes në pikën e kalimit kufitar.
- qëndrojnë në vetë-izolim të detyrueshëm pas hyrjes në Republikën e Kroacisë, me mundësinë e kryerjes së një testi PCR ose një testi të shpejtë të antigjenit; nëse nuk ka mundësi të kryerjes së një testi, të kryejë vetë-izolim për 10 ditë.

Nga përcaktimet e pikës , ka disa përjashtime, përkatësisht:
- punëtorë ose persona të vetëpunësuar, përfshirë punëtorët shëndetësorë, punëtorët në kufi dhe punëtorët sezonalë siç përcaktohet në Udhëzimet për Lëvizjen e Lirë të Punëtorëve gjatë Pandemisë COVID-19, me kusht që ata të mos qendrojnë në Republikën e Kroacisë ose jashtë Republikës së Kroacisë për më shumë se 12 orë;
- nxënësit, studentët dhe praktikantët që udhëtojnë jashtë vendit në baza ditore, me kusht që mos qëndrimi në Republikën e Kroacisë ose jashtë Republikës së Kroacisë për më shumë se 12 orë;
-detarë dhe punëtorë në sektorin e transportit ose ofruesit e shërbimeve të transportit, përfshirë drejtuesit e automjeteve të mallrave që transportojnë mallra për përdorim në territorin shtetëror dhe ata që janë vetëm tranzit;

-diplomatët, stafi i organizatave ndërkombëtare dhe personat që marrin ftesë nga organizatat ndërkombëtare dhe prania fizike e të cilëve kërkohet për mirëfunksionimin e organizatave, personeli ushtarak, oficerët e policisë, personeli i mbrojtjes civile dhe personeli humanitar, në kryerjen e detyrave të tyre,
- personat që udhëtojnë për arsye familjare ose biznesi, përfshirë gazetarët në kryerjen e detyrave të tyre;
-udhëtarët tranzit, me detyrimin të largohen nga Republika e Kroacisë brenda 12 orëve nga hyrja;
- pacientët që udhëtojnë për arsye të nevojshme shëndetësore.
Personat e përmendur në paragrafin 2, mund të kontrollojnë nëse i plotësojnë kushtet për përjashtim nga zbatimi i këtij Vendimi për kufizimin dhe ndalimin e përkohshmë të hyrjes në Republikën e Kroacisë përmes faqes në internet https://mup.gov.hr/Lizg-covid/286210 ose në vendkalimin kufitar.

3. Shtetasit e vendeve anëtare të BE, të zonës Shengen dhe vendeve të lidhura me Shengenin, si dhe anëtarët e familjeve të tyre dhe shtetasit e vendeve të treta (ku hyn edhe Shqipëria) të cilët janë rezidentë afatgjatë, sipas Direktivës së Këshillit 2003/109 / EC të 25 Nëntorit 2003 mbi statusin e Shtetasit e vendeve të treta me qëndrim afatgjatë dhe personat që kanë të drejtë të qëndrojnë nën direktiva të tjera të BE-së ose legjislacionit kombëtar ose viza kombëtare për qëndrim afatgjatë, nëse vijnë nga vende të treta, do të lejohet hyrja në Republikën e Kroacisë nëse plotësojnë kushtet e përmendura në paragrafin 3.
Përjashtimisht, për personat e sipërpërmendur, nuk do të kërkohet paraqitja e një testi PCR negativ, jo më të vjetër se 48 orë, apo detyrimit për testim pas mbërritjes në Republikën e Kroacisë dhe vetë-izolimi deri në marrjen e një pergjigje negative, nëse ata janë:
- profesionistë të shëndetit, studiues në sektorin shëndetësor dhe punonjësit e kujdesit për të moshuarit;
- punonjës të kufirit;
- personel në sektorin e transportit;
-diplomatë, stafi i organizatave ndërkombëtare dhe personat që marrin ftesë nga organizatat ndërkombëtare dhe prania fizike e të cilëve kërkohet për mirëfunksionimin e këtyre organizatave, personeli ushtarak dhe policor, punonjësit humanitarë dhe personeli i mbrojtjes civile në kryerjen e detyrave të tyre;
-udhëtarët tranzit, me detyrimin të largohen nga Republika e Kroacisë brenda 12 orëve nga hyrja;
- personat që udhëtojnë për arsye urgjente familjare/biznesi -me detyrimin të largohen nga Republika e Kroacisë brenda 12 orëve nga hyrja;- pacientët që udhëtojnë për arsye të nevojshme shëndetësore.
- personat që udhëtojnë për shkollim.

4.Shtetasit e vendeve të treta të cilët nuk bëjnë pjesë në një nga pikat e mësipërme, mund të hyjnë në Republikën e Kroacisë vetëm nëse janë:
- profesionistë shëndetësorë, studiues në sektorin shëndetësor dhe punonjësit e kujdesit për të moshuarit;
- punonjës të kufirit;
- personel në sektorin e transportit;
-diplomatë, stafi i organizatave ndërkombëtare dhe personat që marrin ftesë nga organizatat ndërkombëtare dhe prania fizike e të cilëve kërkohet për mirëfunksionimin e këtyre organizatave, personeli ushtarak dhe policor, punonjësit humanitarë dhe personeli i mbrojtjes civile në kryerjen e detyrave të tyre;
- udhëtarët tranzit;
(Për pasagjerët në tranzit, pasi të vërtetohet se ata përmbushin kushtet për të hyrë në vendet e destinacionit, do të lejohen të kalojnë tranzit në territorin kroat, me detyrimin të largohen nga Republika e Kroacisë brenda 12 orëve nga hyrja. Ky rregull mund të zbatohet vetëm nëse largimi nga Republika e Kroacisë bëhet tek një vend fqinj që mundëson hyrjen e tij, d.m.th me një vërtetim zyrtar nga organet shtetërore të vendit pritës se personi në fjalë plotëson kushtet dhe nuk ka pengesa për hyrjen në vend).
- personat që udhëtojnë për shkollim;
- marinarë;
- personat që udhëtojnë për arsye urgjente personale / familjare, arsye biznesi ose që kanë një interes tjetër ekonomik.

Për personat e përmendur në pikë 4, hyrja në Republikën e Kroacisë në Republikën e Kroacisë do të shoqërohet nga:
- prezantimi i një testi negativ PCR për SARS-CoV-2, jo më i vjetër se 48 orë ose
- testimi i PCR për SARS-CoV-2 pas mbërritjes në Republikën e Kroacisë me vetëzolimi deri në marrjen e një përgjigje negative.
Masa të veçanta epidemiologjike zbatohen për personat e përmendur në pikën 4, gjatë kalimit të kufijve të Republikës së Kroacisë, kur ata vijnë nga vendet e renditura në faqen e internetit të Institutit Kroat të Shëndetit Publik: https://www.hzjz.hr/ravnateljstvo/popis-drzava-za-koje :
- prezantimi i një testi negativ PCR për SARS-CoV-2, jo më i vjetër se 48 orë dhe
- caktimi i masës së vetë-izolimit të detyrueshëm për një periudhë prej 14 ditësh.
Personat e përmendur më sipër, mund të shkurtojnë periudhën e vetë-izolimit nëse në ditën e shtatë të vetë-izolimit ata kryejnë një test PCR për SARS-CoV-2, me shpenzimet e tyre, në një institucion të autorizuar për të kryer testet PCR, dhe marrin një rezultat negativ.

Ky vendim lë në fuqi masat e marra në vendimin e Qeverisë nr. 20 datë 25.03.2021, në zonat ku incidenca e rasteve të reja është 4 – 7.5 për 1000 banorë, gjatë ditëve të fundjavës (e premte, e shtunë, e diele) lëvizja e personave do të ndalohet në intervalin kohor 20:00 – 05:00 dhe operatorët ekonomikë do të funksionojnë në intervalin 05:00 – 18:00, me përjashtim të farmacive, karburanteve dhe atyre që ofrojnë shërbim *delivery*. Në zonat ku incidenca është më e lartë se 7.5 për 1000 banorë, kufizimet e mësipërme do të zbatohen gjatë të gjitha ditëve të javës. Gjithashtu, ndalohen grumbullimet në rrugë me më shumë se 6 persona, nëse këta nuk janë të të njëjtës familje, lëvizja në makinë e më shumë se 3 personave, nëse këta nuk janë të të njëjtës familje. organizimet e festave familjare si dasma, pagëzime, përvjetorë, etj. si në ambientet e jashtme ashtu dhe në ato të brendshme.

Theksojmë se, duke filluar nga data 28 mars 2021, në përditësimin e listës së vendeve, në bazë të koeficientit të riskut, Shqipëria është hequr nga lista e vendeve me rrezik të lartë epidemiologjik. Për rrjedhojë, shtetasit që plotësojnë një nga kushtet e mësipërme, për të hyrë në Rumani, nuk kanë detyrimin e paraqitjes së një testi negativ RT-PCR ose t'i nënshtrohen karantinës.

Kujtojmë se mbajtja e maskës është e detyrueshme në të gjitha ambientet e brendshme, transportin publik, si dhe në të gjitha ambientet e jashtme.

- **Rusia**

Bazuar në urdhrin e Qeverisë së Federatës Ruse të datës 16.03. 2020 №635-p, nga data 18.03.2020 është kufizuar hyrja në Federatën Ruse për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, përfshirë ata që vijnë nga territori i Republikës së Bjellorusisë.

Këto kufizime nuk zbatohen ndaj:
- nëpunësve të akredituar ose të emëruar të përfaqësive diplomatike dhe organeve konsullore të shteteve të huaja në Federatën Ruse, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësive të tyre, përfaqësive të tjera zyrtare të shteteve të huaja që ndodhen në territorin e Federatës Ruse, si edhe pjesëtarëve të familjeve të personave të lartpërmendur;
- shoferëve të makinave të komunikacionit ndërkombëtar automobilistik, ekuipazhet e avionëve dhe anijeve detare dhe lumore, ekuipazhet e trenave dhe brigadëve të lokomotivave të komunikacionit ndërkombëtar hekurudhor;
- anëtarëve të delegacioneve zyrtare, atyre që janë pajisur me vizë diplomatike dhe shërbimi, si edhe personave të pajisur me vizë private të lëshuar në lidhje me vdekjen e të afërmit;
- personave me banim të përhershëm në territorin e Federatës Ruse, si edhe pasagjerëve që kalojnë tranzit përmes pikave ajrore të kalimit dhe bien në kategorinë e regjimit pa viza;

Për pasojë, nga data e sipërpërmendur është ndërprerë përkohësisht pranimi i dokumenteve, aplikimi dhe lëshimi i vizave të të gjitha kategorive, përveç atyre të përmendura më lart, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi. Përjashtim bëjnë rastet e lëshimit të vizave të zakonshme private për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, që vijnë në Federatën Ruse në lidhje me vdekjen e një të afërmi, vetëm nëse ata do të paraqesin dokumentet, që vërtetojnë qëllimin e hyrjes: një telegram i vërtetuar nga noteri apo një kopje e dëshmisë së vdekjes ose vërtetim i vdekjes, si edhe kopje të dokumentit që verifikojnë lidhjet familjare.
Siç shihet, në listë mungojnë shtetasit e huaj me qëndrim të përkohshëm, siç mund të jenë studentët apo të huajt që ndodhen përkohësisht në Federatën Ruse me kontratë pune.

Në njoftimin e MPJ ruse të afishuar dhe në Ambasadën e këtij vendi në Tiranë thuhet, se këto masa janë të përkohshme dhe janë kushtëzuar nga rrethanat e veçanta, të shkaktuara nga nevoja për kujdesin ndaj shëndetit të popullsisë së Federatës Ruse gjatë periudhës së pandemisë së koronavirusit COVID-19 në botë.

- **Serbia**

1. Me qëllimin e parandalimit të importit të sëmundjes infektive në territorin e Republikës së Serbisë, shtetasit e huaj që vijnë në Republikën e Serbisë nga të gjitha vendet e botës, me përjashtim të Republikës së Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, do të lejohen të hyjnë në Republikën e Serbisë vetëm me kusht që ata të kenë test negativ RT-PCR ndaj virusit SARS-CoV-2, jo më të vjetër se 48 orë, të lëshuar nga laborator referues i vendit nga vijnë ose vendi që ata po hyjnë në Republikën e Serbisë. Nëse do të ketë vonesë gjatë hyrjes në

Republikën e Serbisë që nuk mund t'i atribuohet pasagjerit, por ekzistencës së një ngjarje të jashtëzakonshme që nuk mund të parashikohet, shmanget ose eliminohet (vonesa/shtyrja e
fluturimit, nisja e autobusëve ose e trenave, ose ngjarje e ngjashme), atëherë testi nuk mund të jetë më i vjetër se 72 orë nga hyrja në Republikën e Serbisë.

Personat që vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vend të një testi negativ RT-PCR, do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Serbisë nën të njëjtat kushte me një test negativ të shpejtë antigjen FIA.

Kërkesa e sipërcituar për të hyrë në Republikën e Serbisë, nuk do të zbatohet për:

- shtetasit e huaj që tranzitojnë nëpër Republikën e Serbisë. Transiti për shtetasit e huaj është i kufizuar në një periudhë jo më të gjatë se 12 orë nga momenti i hyrjes në territorin e Republikës së Serbisë;
- ekuipazhi dhe ekuipazhi i kabinës së avionëve, destinacioni përfundimtar i të cilëve është Republika e Serbisë;
- ekuipazhi, personeli dhe pasagjerët që tranzitojnë ose transferohen përmes aeroporteve ndërkombëtare të Republikës së Serbisë;
- anëtarët e akredituar të stafit të misioneve diplomatike të huaja, postat konsullore dhe zyrat rezidente të organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, që janë mbajtës të kartave speciale të identitetit dhe dokumenteve të identifikimit të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë të Republikës së Serbisë;
- të miturit deri në 12 vjeç, me kusht që prindi, kujdestari ose ndonjë person tjetër që e shoqëron fëmijën të ketë test negativ RT-PCR, nëse është i nevojshëm;
- shtetas të huaj me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme në Republikën e Serbisë;
- anëtarët e ushtrisë së huaj, policisë dhe shërbimeve të tjera të sigurisë, që po tranzitojnë nëpër territorin e Republikës së Serbisë ose të cilët po vijnë në Republikën e Serbisë për qëllime zyrtare para njoftimit.

Kërkesa e sipërcituar për të hyrë në Republikën e Serbisë, nuk do të zbatohet për shtetasit e huaj, që kryejnë transport ndërkombëtar, për qëllime të ngarkimit ose shkarkimit të mallrave ose për transportin e njerëzve në ose përmes Republikës së Serbisë, kur bëhet fjalë për ekuipazhet e:

- mjeteve motorike të ngarkesave, që transportojnë mallra nga trafiku rrugor. Në rast të trafikut tranzit, ky i fundit është i kufizuar në një periudhë jo më të gjatë se 12 orë nga momenti i hyrjes në Republikën e Serbisë;
- anije mallrash, që transportojnë mallra në një nga portet serbe. Në rast të lundrimit tranzit në rrugën ujore ndërkombëtare në territorin e Republikës së Serbisë, kjo e fundit do të kufizohet në një periudhë jo më të gjatë se 90 orë për formacionet e anijes dhe 60 orë për mjetet ujore vetëlëvizëse nga momenti kur ata hyjnë në Republikën e Serbisë në rast të lundrimit në rrjedhën e sipërme, ose për një periudhë

jo më të gjatë se 72 orë për formacionet e anijeve dhe 54 orë për mjetet vetëlundruese nga momenti kur ata hyjnë në territorin e Republikës së Serbisë në rast të lundrimit në rrjedhën e poshtme;

- autobusët e udhëtarëve midis qyteteve ose në distanca të gjata, në të dyja rastet tranzit dhe në rast se kanë si destinacion përfundimtar ose nisës Republikën e Serbisë;
- formacionet e trenave dhe ekuipazhet e tyre shoqëruese;
- karvanet humanitare të rregulluara dhe të aprovuara përmes kanaleve diplomatike.

Kërkesa e sipërcituar për të hyrë në Republikën e Serbisë, në lidhje me reciprocitetin, nuk do të zbatohet për:

- shtetasit nga vendet fqinje nga zona kufitare, që janë duke kryer punë në terren dhe kanë tokë bujqësore në territorin e Republikës së Serbisë, të cilët janë të detyruar të kenë kur kalojnë kufirin shtetëror për kryerjen e punës në terren, dëshmi me shkrim të pronësisë mbi këtë tokë ose deklaratë me shkrim nga pronari i tokës se personi në fjalë po kryen punime në terren në tokën e tij;
- shtetas nga vendet fqinje, që banojnë në zonën kufitare, por janë të punësuar në territorin e Republikës së Serbisë, dokument i lëshuar nga punëdhënësi i tyre nga Republika e Serbisë, një dokument që vërteton punësimin e tyre;

2. Shtetas të huaj që posedojnë një leje qëndrimi të përkohshme ose qëndrimi të përhershëm në Republikën e Serbisë, që vijnë nga të gjitha vendet e botës, me përjashtim të Republikës së Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, kur hyjnë në Republikën e Serbisë dhe të cilët nuk kanë test negativ RT-PCR të virusit SARS-CoV-2 të lëshuar nga laborator referimi nga vendi nga i cili ata vijnë, ose hyjnë në Republikën e Serbisë, ose personat që vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët nuk kanë një test negativ të shpejtë antigjen FIA, jo më të vjetër se 48 orë nga data e lëshimit, do t'u dorëzohet kur hyjnë në Republikën e Serbisë, në një pikë kontrolli një njoftim me shkrim – këshillë mjekësore se si të ruhen gjatë masës së karantinës në shtëpi për një periudhë 10 ditore nga momenti që ata kanë kaluar kufirin shtetëror dhe detyrimisht të njoftojnë në qendrën përkatëse të kujdesit shëndetësor COVID ose institutin kompetent për shëndetin publik brenda 24 orëve nga kalimi i kufirit shtetëror nëpërmjet deklarimit të tyre elektronik në adresën elektronike: www.e-zdravlje.gov.rs

Detyrimi për të pasur një test negativ RT-PCR për virusin SARS-CoV-2, ose test negativ të shpejtë antigjen FIA për personat që vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe detyrimi për të raportuar në klinikën e kujdesit shëndetësor ose institutin kompetent për shëndetin publik brenda 24 orëve nga kalimi i kufirit shtetëror nuk vlen për:

- anëtarët e akredituar të stafit të misioneve diplomatike të huaja, postet konsullore dhe zyrat rezidente të organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë anëtarët e familjeve të tyre, që janë mbajtës të kartave speciale të identitetit, që janë dokumente identifikimi të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë;
- personat nga zona kufitare që kryejnë punë bujqësore ose që kanë tokë bujqësore në territorin e Republikës së Serbisë, të cilët duhet të tregojnë, kur kalojnë kufirin shtetëror për të kryer punën e përmendur për tokën, një dëshmi të pronësisë mbi tokën bujqësore ose një deklaratë të pronarit të tokës bujqësore që personi në fjalë është duke kryer punë bujqësore në tokën e tij;
- personat nga vendet fqinje që jetojnë në zonën kufitare, por që janë të punësuar në territorin e Republikës së Serbisë, një dokument i lëshuar nga punëdhënësi i tyre nga Republika e Serbisë që provon punësimin e tyre;
- ekuipazhi dhe ekuipazhi i kabinës së aeroplanëve, destinacioni përfundimtar i të cilëve është Republika e Serbisë;
- anëtarët e ekuipazhit që kryejnë transportin ndërkombëtar, për qëllime të ngarkimit ose shkarkimit të mallrave ose për transportin e personave në ose përmes Republikës së Serbisë, kur ka të bëjë me ekuipazhe të;

- automjeteve me ngarkesë që kryejnë transport ndërkombëtar rrugor. Në rast tranziti, ai është i kufizuar në një periudhë jo më të gjatë se 12 orë nga momenti i hyrjes në territorin e Republikës së Serbisë;
- anijeve të mallrave që transportojnë mallra në një nga portet e Serbisë. Në rast të lundrimit tranzit në një rrugë ujore ndërkombëtare në territorin e Republikës së Serbisë, kjo e fundit do të kufizohet në një periudhë jo më të gjatë se 90 orë për formacionet e anijeve dhe 60 orë për anijet vetëlëvizëse nga momenti i hyrjes në territorin e Republika e Serbisë, kur bëhet fjalë për lundrimin në rrjedhën e sipërme, kjo është për një periudhë jo më të gjatë se 72 orë për formacionet e anijeve dhe 54 orë për anijet vetëlëvizëse nga momenti i hyrjes në territorin e Republikës së Serbisë, kur bëhet fjalë për rrjedhën e poshtme të lundrimit;
- autobusët e udhëtarëve midis qyteteve ose në distanca të gjata, në të dyja rastet tranzit dhe në rast se kanë si destinacion përfundimtar ose nisës Republikën e Serbisë;
- formacionet e trenave dhe personeli i tyre shoqërues;
- karvanët humanitare të rregulluara dhe aprovuara përmes kanaleve diplomatike.
- të miturit deri në moshën 12 vjeç;
- personat të cilët kanë qëndruar jashtë territorit të Republikës së Serbisë për më pak se 48 orë dhe kanë një test negativ RT-PCR të virusit SARS-CoV-2 të lëshuar nga laborator referimi në Republikën e jo më të vjetër se 48 orë nga data e lëshimit. Nëse do të ketë vonesë gjatë hyrjes në Republikën e Serbisë që nuk mund t'i atribuohet pasagjerit, por ekzistencës së një ngjarje të jashtëzakonshme që nuk mund të parashikohet, shmanget ose eliminohet (vonesa/shtyrja e fluturimit, nisja e autobusëve ose e trenave, ose ngjarje e ngjashme), atëherë testi nuk mund të jetë më i vjetër se 72 orë nga hyrja në Republikën e Serbisë.

Hyrja në Republikën e Serbisë për Arsye Biznesi
Shtetasit e huaj që vijnë në Republikë të Serbisë për qëllime biznesi, para njoftimit në Dhomën e Tregtisë të Serbisë, do të lejohen të hyjë në Republikën e Serbisë me kusht që brenda një afati prej 24 orësh nga momenti që ata të kalojnë kufirin shtetëror, ata do t'i paraqesin Dhomës së Tregtisë të Serbisë një test negativ RT-PCR ose një test antigjeni ndaj virusit SARS -CoV-2, lëshuar nga një laborator referues në Republikën e Serbisë.

Dhoma e Tregtisë e Serbisë do t'i paraqesë Ministrisë së Brendshme - Departamenti për Policinë Kufitare një njoftim për personin që mendohet të kalojë kufirin pa vonesë dhe jo më vonë se 24 orë para kohës së parashikuar për të kaluar kufirin.

Nëse personi i supozuar dështon të paraqesë një test negativ RT-PCR ose test antigjeni në virusin SARS-CoV-2 brenda afatit 24 orësh nga momenti i kalimit të kufirit shtetëror ose testi duhet të jetë pozitiv ndaj virusit SARS-CoV -2, Dhoma e Tregtisë e Serbisë menjëherë do të informojë zyrën përkatëse të shëndetit publik.

- **Sllovaki**

Sllovakia ndodhet në gjendje të jashtëzakonshme, së fundmi miratuar më 11 Mars 2021. Hyrja në Republikën Sllovake nga 12 Mars, 2020, është e kufizuar me masat e mëposhtme:
Të gjithë personat, territori i Republikës Sllovake janë të detyruar që:

a) të regjistrohen më së voni menjëherë pas hyrjes në Republikën Sllovake në faqen e internetit korona.gov.sk/ehranica,
b) gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Republikës Sllovake të paraqesin një konfirmim të përmbushjes së detyrimit sipas paragrafit 4 shkronja a) anëtarëve të Forcës Policore të Republikës Sllovake,
c) i nënshtrohen një diagnoze laboratorike të COVID-19 më së shpejti në ditën e tetë të izolimit në mjedisin e shtëpisë ose në një mjedis akomodimi në karantinë,
d) fëmijët nën moshën dhjetë vjeç janë të detyruar t'i nënshtrohen një diagnoze të COVID-19 nëse përcaktohet kështu nga zyra përkatëse rajonale e shëndetit publik ose ofruesi i kujdesit shëndetësor i cili siguron kujdes shëndetësor në specializimin pediatri dhe me të cilin fëmija ka lidhur një marrëveshje të kujdesit shëndetësor,

e) personat që hyjnë në territorin e Republikës Sllovake me avion janë gjithashtu të detyruar të plotësojnë një format elektronik për kërkimin e pasagjerëve në lidhje me mbrojtjen e shëndetit publik.

Detyrimet e përmendura më sipër nuk zbatohen për personat e përmendur në Seksionet 4 deri në 8 të Dekretit (varëset, punonjësit e mjekësisë, personat që gëzojnë privilegje dhe imunitete diplomatike, kategori të caktuara të personave tranzit etj.) (https://www.mzv.sk/web/en/covid-19)

Kontakt mbi regjimin kufitar: suhcp@minv.sk.
Kontakt mbi masat epidemiologjike të zbatueshme me rastin e hyrjes në territorin e Republikës Sllovake: koronapodnety@uvzsr.sk.
Kërkesat për informacion mbi lëshimin e vizave për hyrje në Republikën Sllovake duhet t'i drejtohen ambasadës përkatëse ose konsullatës së përgjithshme të Republika Sllovake.

Mbërritja në Republikën Sllovake përmes kufirit të brendshëm:

Shtetasit e vendeve të treta, shtetasit e BE / EEA si dhe shtetasit e Konfederatës Zvicerane mund të hyjnë në Republikën Sllovake përmes kufijve të brendshëm tokësorë të Republikës Sllovake me Republikën Çeke, Republikën e Austrisë, Republikën e Polonisë dhe Hungarinë, si dhe kufijtë e brendshëm ajrorë (pikat e kalimit kufitar të vendosura në aeroportet në territorin e Republikës Sllovake) nën kushtin e respektimit të masave përkatëse të karantinës së Autoritetit të Shëndetit Publik (vetë-izolimi, testimi për COVID-19, regjistrimi në faqen e internetit http://korona.gov.sk/ehranica/ etj.) në përputhje me dispozitat e Dekretit të Autoritetit të Shëndetit Publik të Republikës Sllovake, Kategoritë e personave, për të cilët zbatohen përjashtimet nga masat e karantinës përcaktohen në Seksionet 4 - 8 të Dekreti i Autoritetit të Shëndetit Publik të Republikës Sllovake.

Një i huaj me një dokument të vlefshëm udhëtimi dhe një vizë ose një leje qëndrimi (nëse kërkohet), i cili ka hyrë legalisht ose po qëndron në zonën Shengen, mund të hyjë gjithashtu në territorin e Republikës Sllovake, pavarësisht nga qëllimi i udhëtimit në Sllovake Republikë (udhëtime biznesi, vizitë e familjes ose miqve, çifte të pamartuar etj.) Kushtet e hyrjes në vendin (vendet) e tranzitit duhet të verifikohen me autoritetet kompetente të vendit tranzit dhe kompaninë përkatëse ajrore. Një konfirmim individual që vërteton autorizimin e hyrjes së shtetasit të huaj në Republikën Sllovake përmes kufijve të brendshëm nuk kërkohet.

Mbërritja në Republikën Sllovake përmes kufirit të jashtëm:

Kufiri i jashtëm (d.m.th. kufiri Shengen) është një kufi tokësor midis Republikës Sllovake dhe Ukrainës. Kufijtë e jashtëm ajrorë përfshijnë edhe aeroporte ndërkombëtare në Republikën Sllovake (Aeroporti M. R. Štefánik, Aeroporti Poprad-Tatry, Aeroporti Koçice), në rast të mbërritjeve nga vendet jashtë territorit të Shengenit.
Me kusht që personi të respektojë të gjitha masat epidemiologjike, mbërritja në Republikën Sllovake përmes kufirit të jashtëm është e mundur për shtetasit e BE dhe kategoritë e mëposhtme të shtetasve të vendeve të treta:

a) Shtetasit e vendeve të treta që janë familjarë të personave me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm në Republikën Sllovake ose të afërm të shtetasve Sllovake, dmth. burrat / gratë, fëmijët e mitur, prindërit e një fëmije të mitur që hyjnë në Republikën Sllovake. Fëmijë të mitur, burra / gra nuk duhet të udhëtojnë së bashku me shtetasin e huaj; marrëdhënia e tyre familjare do të demonstrohet duke paraqitur, për shembull, një certifikatë lindjeje ose certifikatë martese (Nëse një shtetas i huaj nuk mban origjinalin, mjafton një kopje standarde e dokumentit.) Nëse dokumenti ekziston vetëm në një gjuhë të huaj, shtetasi i huaj duhet të sigurojë përkthimin e tij (mjafton një përkthim jo-zyrtar). Kur i nënshtrohet kontrollit, shtetasi i huaj duhet të paraqesë origjinalin në gjuhën e huaj dhe përkthimin e tij.

b) Shtetasit e vendeve të treta që kanë një qëndrim të vlefshëm në territorin e Republikës Sllovake, në përputhje me Aktin Nr. 404/2011 për Vendbanimin e Shtetasve të Huaj, të ndryshuar, dhe që paraqiten me një leje qëndrimi të vlefshme, një ID qëndrimi dhe një deklaratë që konfirmon se vendbanimi i tyre është regjistruar, ose që janë mbajtës të vizës kombëtare të lëshuar nga misioni diplomatik i Republikës Sllovake. Hyrja e shtetasve të vendeve të treta për qëllimin e ndjekjes së kopshtit, shkollës bazë, shkollës së mesme ose universitetit në territorin e Republikës Sllovake konsiderohet një leje qëndrimi e vlefshme në përputhje me këtë pikë për sa kohë që personi është në gjendje të paraqesë një dokument konfirmimi të këtij fakti.

c) Shtetasit e huaj që plotësojnë kriteret për një përjashtim të përgjithshëm të përcaktuar në Seksionin 4, Seksionin 5, Seksionin 6 para. 1 shkronja a) deri në c), dhe Seksioni 8 i Dekretit të Autoritetit të Shëndetit Publik të Republikës Sllovake i cili vendos masa në rast të një kërcënimi për shëndetin publik në lidhje me detyrimet karantinore të personave pas hyrjes në territorin e Republikës Sllovake në formulimi i ndryshimeve të tij të mëvonshme (p.sh. persona tranzit, persona që kujdesen për një të afërm të ngushtë).
d) Shtetasit e vendeve të treta, të cilët janë mbajtës të një përjashtimi në përputhje me Seksionin 7 të Dekretit të Autoritetit të Shëndetit Publik të Republikës Sllovake. Personi, të cilit i është dhënë një përjashtim, duhet të ketë një rezultat negativ të testit RT-PCR për COVID-19 jo më i vjetër se 72 orë kur hyn në territorin e Republikës Sllovake. Në raste të justifikuara, Autoriteti i Shëndetit Publik i Republikës Sllovake mund të japë një përjashtim nga ky detyrim bazuar në një kërkesë të arsyetuar me shkrim të një anëtari të Qeverisë së Republikës Sllovake nën autoritetin e tij.

Në disa raste, përjashtimi nga masat e karantinës mund t'i nënshtrohet pëlqimit të ministrisë përkatëse ose Autoritetit të Shëndetit Publik të Republikës Sllovake, siç përcaktohet në pdf Dekreti i Autoritetit të Shëndetit Publik të Republikës Sllovake (pdf ; 328,47 KB)

Të gjithë personat që mbërrijnë në Sllovaki me avion janë të detyruar të plotësojnë formularin e regjistrimit: Formularin e Shikimit të Pasagjerëve të Shëndetit Publik dhe t'ju binden të gjitha masave epidemiologjike siç urdhërohet nga Autoriteti i Shëndetit Publik të Republikës Sllovake. Kërkesa për pëlqimin e Ministrisë së Brendshme të Republikës Sllovake me tranzit do të dërgohet në: corona.transit@minv.sk.

Kontaktet:
Autoriteti i Shëndetit Publik të Republikës Sllovake - 0917 222 682, koronapodnety@uvzsr.sk

- **Slloveni**

Qeveria sllovene ka vendosur shtrëngimin e masave në vend, në përpjekje për të frenuar përhapjen e koronavirusit, duke vendosur mbyllje të plotë të jetës publike në vend, që hyn në fuqi në datën 1 prill deri në datën 12 prill.

Për vendet me një situatë të paqëndrueshme epidemiologjike të përfshira në zonën e kuqe, ku bën pjesë edhe Shqipëria, do t'ju kërkohet të qëndrojnë në karantinë për një periudhë dhjetë ditore.

Në Slloveni mund të udhëtojnë vetëm ata shtetas shqiptarë, që kanë leje qëndrimi ose pune dhe dokument të vlefshëm udhëtimi, përfshirë përmbushjen e kërkesave anticovid.

Mund të udhëtohet tranzit në territorin e Sllovenisë drejt Shqipërisë në drejtim tokësor brenda 6 orësh, me dokumente të rregullta udhëtimi.

Individët nuk do të jenë të detyruar të kryejnë karantinë kur kalojnë kufirin dhe hyjnë në territorin e Sllovenisë, nëse paraqesin:

- një test negativ PCR, të kryer jo më vonë se 48 orë në një vend anëtar të BE-së ose në një vend të zonës Schengen;
- një vërtetim të rezultatit pozitiv të testit PCR pasi të kenë kaluar më shumë se 21 ditë nga kryerja e tij, por jo më parë se gjashtë muaj, të kryer në një vend anëtar të BE-së ose në një vend të zonës Schengen;
- një certifikatë mjekësore që konfirmon se personi ka kaluar COVID-19 në një periudhë jo më të largët se 6 muaj, e lëshuar nga një vend anëtar i BE-së ose një vend i zonës Schengen;
- një vërtetim të vaksinimit ndaj COVID-19 që tregon se kanë kaluar të paktën shtatë ditë që nga marrja e dozës së dytë të vaksinës Pfizer-BioNTech, të paktën 14 ditë nga doza e dytë e vaksinës Moderna ose 21 ditë nga doza e parë e vaksinës AstraZeneca, në një vend anëtar të BE-së ose një vend të zonës Schengen.

Informacione të detajuara dhe të përditësuara do t'i gjeni në linkun:

https://www.gov.si/en/topics/coronavirus-disease-covid-19/border-crossing/

- **Spanja**

Për shkak të pandemisë Covid-19 në Spanjë është vendosur gjendja e jashtëzakonshme. Për këtë arsye Spanja ka adaptuar rregullimet e Bashkimit Evropian për kufizimin e udhëtimeve në vendet anëtare. Shtetasit shqiptarë nuk mund të udhëtojnë për në Spanjë. Përjashtim bëjnë ata që kanë leje qëndrimi spanjolle ose që kanë arësye të domosdoshme. Këto arsye vlerësohen nga vetë autoritetet spanjolle.

Për shtetasit që mund të udhëtojnë për në Spanjë dhe hyjnë në territorin e saj përmes porteve ose aeroporteve janë të detyrueshme:

1) Paraqitja e testit negativ anti-covid, të bërë brenda 72 orëve të fundit. Bëjnë përjashtim fëmijët nën moshën 6 vjeç. Mungesa e testit dënohet me gjobë;
2) Rregjistrimi në portalin shtetëror www.spth.gob.es/ përmes aplikacionit Spain Travel Health-SpTH. Udhëtarët e huaj, përfshi dhe shtetasit shqiptarë, regjistrohen duke plotësuar formularin në këtë faqe dhe marrë kodin QR që gjenerohet në përfundim të procedurës së regjistrimit.
3) Dokumenti konfirmues për arsyen e udhëtimit për në Spanjë:
- Leja e qëndrimit spanjolle; ose
- Justifikimi për arësyen e domosdoshme të udhëtimit për në Spanjë, të konfirmuar më parë nga autoritetet spanjolle;

Masat për gjendjen e jashtëzakonshme në Spanjë janë në përgjegjësinë e rajoneve autonome. Informacioni më i fundit për secilin rajon gjenden në linkun:

https://www.mscbs.gob.es/profesionales/saludPublica/ccayes/alertasActual/nCov/estrategia/medidasPrevCCAA.htm?fbclid=IwAR26rOQpe1iYY6jJCClVS95y_x_7K2LST30NVCC3LL9ON1AfYD7i5okpfJU

Udhëtarët shqiptarë duhet ta mënjanojnë planifikimin e tranzitimit përmes Spanjës.

Për të udhëtuar nga Spanja në Shqipëri shtetasit shqiptarë duhet të kenë dokumentacionin e rregullt të udhëtimit. Si dokument i rregullt udhëtimi konsiderohet pasaporta e vlefshme ose leja e kalimit. Me leje kalimi pajisen nga Ambasada në Madrid shtetasit që nuk kanë pasaportë të vlefshme. Leja e kalimit lëshohet vetëm për udhëtimin për në Shqipëri. Aplikimi për lejekalimi bëhet në portalin e-Albania.

Udhëtarët shqiptarë nga Spanja nuk kanë të detyrueshme paraqitjen e një testi negativ për të hyrë në Shqipëri. Më parë duhet të informohen tek linja ajrore, nëse vetë linja ajrore kërkon paraqitjen e testit për imbarkimin. Po

ashtu nuk është e detyrueshme karantina.

- **Suedia**

Kufizimi i hyrjes në Suedi nga shtetet e tjera është zgjatur deri më 31 maj 2021.
Rregulli i përgjithshëm është se të huajt që udhëtojnë në Suedi nga një vend jashtë ZEE (Zonës Ekonomike Ekskluzive), do ti ndalohet hyrja dhe do të refuzohen.

Çdo shtetas i huaj nga mosha 18 vjeç e lart, që i lejohet te udhëtoj drejt Suedisë, duhet të dokumentojnë se nuk ka një infeksion aktiv të Covid-19 për të hyrë në Suedi. Testi nuk duhet te jete me i vjetër se 48 orë.

Vini re: Autoriteti Suedez i Policisë nuk lëshon asnjë lloj para-miratimi ose njoftimi. Vendimi për secilin rast individual do të merret pas mbërritjes në pikën e kontrollit kufitar bazuar në dokumentacionin e paraqitur.
Raste përjashtimore nga ndalimi i hyrjes:

· Shtetas të vendeve të ZEE, Zvicrës, Andorrës, Monakos, San Marinos ose Vatikanit;
· Shtetas me rezidencë apo të drejtë qëndrimi në vendet e sipërcituara;
· Shtetas që kanë viza të tipit D në Suedi, ose në vendet e sipërcituara me kohëzgjatje më tepër se 3 muaj;
· Individët me lidhje të dokumentuara familjare, si p.sh. bashkëshorti/bashkëshortja; bashkëjetuesi, fëmijët e një shtetasi Suedez, shtetasi të ZEE ose të huaji me leje qëndrimi ose vizë të tipit D në Suedi, ose ne Shtetet e tjera të ZEE; si dhe,
· Përjashtime për shkak të funksionit.

Lutemi për një informacion më të plotë dhe të detajuar të lexoni në këtë link: https://polisen.se/en/the-swedish-police/the-coronavirus-and-the-swedish-police/travel-to-and-from-sweden/#Non-EEA

- **SHBA**

Nga data 26 janar 2021, rregullat e hyrjes përmes transportit ajror të udhëtarëve ndërkombëtarë në SHBA do të ndryshojnë. Që prej kësaj date, SHBA do të kërkojë që të gjithë këta udhëtarë të jenë testuar negativë për Covid në tre ditët e fundit përpara nisjes së udhëtimit drejt SHBA dhe të jenë të pajisur me dokumentin që verifikon rezultatin 'Negativ' të testit, qoftë në formë të shkruar apo elektronike, në mënyrë që ta paraqesin tek stafet e linjave ajrore.

Pas mbërritjes në territorin e SHBA, udhëtarët janë të detyruar të qëndrojnë për 7 ditë në karantinë, në ambientet ku do të akomodohen, dhe do duhet të testohen sërish 3-5 ditë pas mbërritjes.

Për informacion të azhurnuar, ju lutemi vizitoni faqen: CDC Proof of Negative Test Result

Lista e vendeve ku testimi është i disponueshëm:

https://al.usembassy.gov/updates_covid19/

Nëse mbërrini në një fluturim të drejtpërdrejtë në Shtetet e Bashkuara, prova juaj duhet të bëhet brenda 3 ditëve kalendarike para nisjes së fluturimit tuaj në Shtetet e Bashkuara. Nëse mbërrini në Shtetet e Bashkuara përmes një ose më shumë fluturimeve lidhëse, prova juaj duhet të bëhet në 3 ditë para fluturimit të parë në itinerarin tuaj, por vetëm nëse fluturimet lidhëse janë rezervuar si një rezervim i vetëm për pasagjerët me një destinacion përfundimtar në Shtetet e Bashkuara dhe çdo ndërprerje pune jo më shumë se 24 orë.

Nëse fluturimi juaj lidhës për në SH.B.A.është rezervuar veçmas ose një ndërprerje në itinerarin tuaj zgjat më shumë se 24 orë ose udhëtimi juaj prishet dhe largoheni nga aeroporti, do të duhet të testoheni brenda 3 ditëve para fluturimit tuaj që arrin në SH.B.A.

Do t'ju duhet një test viral (NAAT ose test antigjeni) për të përcaktuar nëse aktualisht jeni të infektuar me COVID-19.

Duhet të kontrolloni me kompaninë tuaj ajrore për të përcaktuar se në çfarë gjuhe mund të paraqiten rezultatet.CDC u kërkon udhëtarëve të ajrit që të kenë një letër ose një kopje elektronike të rezultatit të tyre të provës për rishikim nga linja ajrore para se të hipni dhe për rishikim të mundshëm nga zyrtarët e shëndetit publik pasi të mbërrini në Shtetet e Bashkuara. Pasagjerët gjithashtu do të vërtetojnë vërtetësinë e testit të paraqitur.

Nëse fluturimi juaj vonohet para nisjes, do të duhet të rishikoheni nëse vonesa bën që testi juaj të bjerë jashtë kërkesës së periudhës së testimit para 3-ditësh. Një vonesë gjatë udhëtimit në një itinerar të vazhdueshëm nuk do të bëjë të pavlefshme një provë ndryshe të vlefshme nëse nuk rezulton në largimin tuaj nga terminali i aeroportit ose një ndërprerje që zgjat më shumë se 24 orë.

Çdo pasagjer në një fluturim që hyn në SH.B.A, madje edhe për një lidhje, do të kërkojë testim para nisjes.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ka në plan të sigurojë vaksinime ose shërbime testimi COVID-19 për shtetasit privatë të SHBA jashtë vendit.

Për më shumë informacion në lidhje me kërkesat e testimit të udhëtimit:

https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/travelers/testing-international/

Për më shumë informacion se ku mund të merrni një test jashtë shtetit, udhëtarët duhet të rishikojnë webfaqen përkatëse të Ambasadës.

Në përgjithësi, nëse një shtetas amerikan jashtë vendit përballet me skamje, Departamenti mund të ofrojë lloje të caktuara të ndihmës nëse plotësohen kërkesat e pranueshmërisë; ju mund të gjeni më shumë informacion në lidhje me atë që mund të bëjmë në faqen tonë të internetit: https://travel.state.gov/content/travel/en/international-travel/emergency/emergency-financial-assistance.html/

- **Tunizia**

Shqipëria është në kategorinë e kuqe, të shteteve që nuk iu lejohet hyrja në Tunizi. Atyre që për arsye specifike iu lejohet të hyjnë, duhet të kenë kryer testin COVID-19, 120 orë përpara, si dhe të karantinohen për 7 ditë në një nga hotelet e caktuara.

- **Turqi**

1) Me qëllim kontrollin e numrit të rasteve të COVID-19 dhe në kuadër të masave të reja në Turqi; të gjithë ata që do të udhëtojnë drejt Turqisë në rrugë ajrore (me avion), duke filluar nga data 28/12/2020; dhe nëpërmjet rrugëve tokësore apo detare që nga 30/12/2020, para hyrjes së tyre në vend duhet të jenë të pajisur me rezultatin negativ të testit SARS-CoV-2 PCR të kryer brenda shtatëdhjetë e dy orëve (72 orë) të fundit.

Ata që nuk kanë një test PCR negativ nuk do të lejohen të hipin në avion për të udhëtuar në Turqi. Pra, për udhëtimin në rrugë ajrore, testi negativ është kusht të paraqitet në momentin e udhëtimit.

Sa i përket udhëtimit në rrugë tokësore apo detare, nëse udhëtarët nuk paraqesin testin negativ tek autoritetet zyrtare gjatë hyrjes në pikat kufitare, është kusht të karantinohen në adresën që do të deklarojnë (shtëpi, hotel, etj). Në rast se nuk kanë një vend për të qëndruar, duhet të karantinohen në vendet që do të përcaktohen nga Drejtoritë e Shëndetit Krahinor. Në fund të 7 ditëve karantinë, do t'u kryhet testi PCR, dhe sipas rezultatit karantina 7-ditore do të përfundojë, ose do të vazhdojë trajtimi i tyre më tej në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë turke.Ky rregull vazhdon të zbatohet.

2) Të gjithë personat mbi 6 vjeç të cilët do të udhëtojnë me avion në Turqi, duke filluar nga 15 Marsi 2021, shtatëdhjetë e dy (72) orë para nisjes, nga adresa e postës elektronike register.health.gov.tr/ duhet të plotësojnë "Formularin e hyrjes në Turqi". Plotësimi i formularit të përmendur do të kontrollohet nga linjat ajrore përmes pajisjeve mobile të pasagjerëve ose duke shfaqur një kopje të shtypur. Kjo nuk vlen për pasagjerët që tranzitojnë dhe bëjnë transferime.

- **Ukrainë**

Rezoluta e fundit e nxjerrë nga Kabineti i Ministrave të Ukrainës, më 7 prill 2021, përcakton masa dhe rregulla të reja anti-epidemike për të parandaluar përhapjen e sëmundjes akute të frymëmarrjes COVID-19 të shkaktuar nga koronavirusi SARS-CoV-2 në Ukrainë. Konkretisht:

1. Kërkohet test negativ anti-covid PCR, 72 orë përpara udhëtimit.
2. Duhet sigurim shëndetësor/jete, që mbulon shpenzime Covid-19, kur të hyjnë në Ukrainë.
3. Vetë-izolim që do të monitorohet.

➢ Përjashtim nga këto rregulla për:

- Fëmijët më të vegjël se 12 vjeç.
- Shoferët/anëtarë ekuipazhi të transportit të malrave, autobusat e transportit periodik, anëtarë ekuipazhi të avioneve dhe anijeve, varkave, të trenave dhe lokomotivave.
- Personat që transportojnë qelizat staminale hematopoietike për transplant gjaku.

➢ Për më shumë informacion:

https://traveltoukraine.org/what-you-should-know/coronavirus-information/

- **Uruguaj**

Hyrja e shtetasve të huaj në Uruguaj është e ndaluar me përjashtim të banorëve, shtetasve uruguajanë dhe rasteve të veçanta. Është e nevojshme të paraqitet një test negativ molekular-PCR i kryer brenda një periudhe maksimale prej 72 orësh para udhëtimit. Është e detyrueshme karantina 7-ditore, në fund të së cilës mund të zgjidhet kryerja e një provë tjetër molekulare PCR ose të zgjatet regjimin i karantinës për 7 ditë të tjera shtesë. Kushtet e mësipërme nuk zbatohen për fëmijët nën 6 vjeç. Të gjithë udhëtarët duhet të kenë mbulim shëndetësor të vlefshëm në Uruguaj dhe të paraqesin një Deklaratë Shëndetësore dhe Formularin e Kufirit për të hyrë në vend.

- **Uzbekistan**

Nga 1 tetori 2020, kufizimet për hyrjen e shtetasve të huaj në vend janë hequr në Republikën e Uzbekistanit, me kushtin e zbatimit të rregullave karantinore dhe sanitaro-higjenike.

Janë në fuqi procedurat e mëposhtme:
- vizitorët që mbërrijnë në Uzbekistan me transport ajror dhe hekurudhë duhet të kenë bërë një test PCR për koronavirusin 72 orë para regjistrimit për udhëtim dhe duhet të paraqesin një vërtetimin me rezultatin negativ;
- vizitorët që mbërrijnë në Uzbekistan me transport rrugor duhet të paraqesin një vërtetim për kryerjen e testit PCR për koronavirus brenda 72 orëve të fundit me një rezultat negativ. Në mungesë të një rezultati të testit PCR, ata mund të kryejnë një test të shpejtë për antitrupa ndaj COVID-19 në klinika dhe laboratorë të veçantë në pikat kufitare. Ata lejohen të hyjnë në Uzbekistan vetëm kur dalin me rezultat negativ. Në këtë rast, rezultatet e testit duhet të jenë në anglisht ose rusisht.

- **Venezuela**

Kushdo që dëshiron të hyjë në Venezuelë është i detyruar të paraqesë një provë PCR të bërë maksimumi 72 orë para imbarkimit dhe të paraqesë kodin e marrë në: https://pasedesalud.casalab.com.ve/

- **Zelandë e Re**

Nga data 25 Janar 2021, të gjithë pasagjerët që mbërrijnë në Zelandën e Re, përveç atyre që vijnë nga Australia, Antarktida dhe territoret e ishujve Paqësorë (Ishujt Cook, Shtetet e Mikronezisë, Fixhi, Kiribati, Ishujt Marshall, Nauru, Kaledonia e Re, Niue, Palau, Samoa, Ishujt Solomon, Tokelau, Tonga, Tuvalu, Vanuatu, dhe Wallis dhe Futuna) do të kërkohet të japin prova të një rezultati negativ nga Covid-19 (qoftë PCR / RT-PCR ose një test antigjeni) i ndërmarrë jo më shumë se 72 orë, para orës së fluturimit ndërkombëtar në Zelandën e Re.
Pasagjerët gjithashtu do të jenë të detyruar të kryejnë edhe tre (3) teste Covid-19 gjatë periudhës së tyre të detyrueshme karantinore 14 ditore në Zelandën e Re. Për më shumë informacion:
https://covid19.govt.nz/travel-and-the-border/travel-to-new-zealand/ testimi para nisjes për anrivalët në Zelandën e Re/

- **Zvicër**

-Autoritetet kompetente zvicerane, më datë 7 prill 2021, kanë vendosur përditësimin e masave shtrënguese për ata që udhëtojnë në drejtim të Zvicrës. Një nga ndryshimet me rëndësi për programimin e udhëtimeve tuaja është heqja e Republikës së Shqipërisë nga lista e vendeve me rrezikshmëri të lartë infektim nga COVID-19. Kjo nënkupton se nuk do të ketë më detyrim për karantinimin në momentin e mbërritjes në Zvicër.
-Heqja e Shqipërisë nga kjo listë parashikon që udhëtarët nga vendi ynë në drejtim të Zvicrës, të cilët udhëtojnë në rrugë ajrore do të kenë detyrimin të plotësojnë një formular digjital me të dhëna dhe të paraqesin rezultatin negativ të testit PCR të kryer jo më herët se 72 orë para udhëtimit.
-Për ata që udhëtojnë në rrugë tokësore me mjete transporti publik do të aplikohet vetëm plotësimi i formularit digjital pa pasur detyrimin e paraqitjes së testit negativ PCR, ndërsa ata që udhëtojnë me automjete private në rrugë tokësorë nuk kanë detyrim të paraqesin asnjë nga dokumentet e mësipërme.
Vendimi hyn në fuqi që prej datës 8 prill 2021.

-Masat e reja aplikohen për të gjithë ata të cilët lejohen të udhëtojnë në Zvicër, konkretisht, shtetas shqiptar me leje qëndrimi në Zvicër apo shtetas zviceran të cilët udhëtojnë nga Shqipëria, detaje mbi çështjen në linkun e mëposhtëm:

https://www.bag.admin.ch/bag/en/home/krankheiten/ausbrueche-epidemien-pandemien/aktuelle-ausbrueche-epidemien/novel-cov/empfehlungen-fuer-reisende/quarantaene-einreisende.html

-Përveç këtyre kategorive, autoritetet zvicerane kanë parashikuar dhe raste përjashtimore, siç janë emergjencat shëndetësore apo familjar të shtetasve zviceran ose atyre shqiptarë me leje qëndrimi në Zvicër, lutemi konsultoni

web-link për informacion të detajuar.

https://www.bag.admin.ch/bag/en/home/krankheiten/ausbrueche-epidemien-pandemien/aktuelle-ausbrueche-epidemien/novel-cov/massnahmen-des-bundes.html

-Në zbatim të masave të reja, për udhëtarët që nisen nga Shqipëria dhe kanë destinacion Zvicrën, do të ndjekin hapat si më poshtë vijon:

- Transport Ajror:

1. Plotësimi i Formularit elektronik të hyrjes - formulari në fjalë duhet të plotësohet përpara hyrjes në territorin zviceran. Dokumentin mund ta gjeni në linkun që vijon: https://swissplf.admin.ch/home
2. Paraqitja e rezultatit negativ të testit PCR - nga ky detyrim përjashtohen fëmijët nën 12 vjeç. Testi i shpejt antigen nuk do të pranohet pasi kërkohet test molekular-biologjik. Kërkesa aplikohet për të gjithë udhëtarët, me përjashtim të rasteve të veçanta:

https://www.bag.admin.ch/bag/en/home/krankheiten/ausbrueche-epidemien-pandemien/aktuelle-ausbrueche-epidemien/novel-cov/empfehlungen-fuer-reisende/quarantaene-einreisende.html#103059051

- Transport tokësor publik:

1. Plotësimi i Formularit elektronik të hyrjes - formulari në fjalë duhet të plotësohet përpara hyrjes në territorin zviceran. Dokumentin mund ta gjeni në linkun që vijon: https://swissplf.admin.ch/home

- Në përgjithësi këshillohet të respektohen masat e shpallura zyrtarisht dhe të demonstrohet mirëkuptim i përbashkëtat. Gjithkush ka përgjegjësinë individuale dhe kolektive për t'i respektuar këto rregulla. Misionet diplomatike apo ato ndërkombëtare, mund të vendosin vetë të jenë më strikt me masat për stafin apo vizitorët. Të gjithë personat që gëzojnë privilegje dhe imunitete kanë për detyrë të respektojnë ligjet dhe rregullat e shtetit pritës, në veçanti masat e marra nga autoritetet për të kufizuar përhapjen e COVID-19. Për më shumë informacion për lëvizjen në vendet e BE-së:
  https://reopen.europa.eu/en/